



Strategjia e Bashkëpunimit Zviceran Shqipëri 2018-2021



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Sekretariati i Shtetit për
Çështje Ekonomike SECO

Parathënie

Qëndrueshmëria dhe prosperiteti i vendeve të Ballkanit Perëndimor janë synime themelore të politikës së jashtme dhe të sigurisë së Zvicrës. Angazhimi i Zvicrës në rajon nisi në vitet '90, duke siguruar asistencë humanitare dhe strehimi për shumë njerëz.


Ndërmjet viteve 1992 dhe 1997 bashkëpunimi i Zvicrës me Shqipërinë u shndërrua në një program të plotë për mbështetjen e procesit të tranzicionit. Ky bashkëpunim është zhvilluar në sajë të një partneriteti të besueshëm me Shqipërinë dhe të bazuar në interesa reciproke. Strategjia e re e Bashkëpunimit Zviceran 2018-2021 është e rrënjësor në frymën e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Qeverive të Zvicrës dhe të Shqipërisë. Ajo përfaqëson një përkushtim të fortë për vijimin e mbështetjes për proceset e tranzicionit ekonomik, shoqëror dhe politik në Shqipëri dhe bazohet në praninë afatgjatë të Zvicrës në vend dhe në arritjet e mëparshme. Bashkëpunimi Zvicër-Shqipëri është forcuar me kalimin e viteve. Sot, Zvicra është një ndër tre partnerët më të mëdhenj të bashkëpunimit dypalësh me Shqipërinë.

Shqipëria ka bërë progres të qenësishëm për nga stabiliteti politik dhe makroekonomik. Zvicra është e vendosur të mbështesë vendin në trajtimin e sfidave të mbetura në sektorë të veçantë në përputhje me përparësitë e përcaktuara nga qeveria e Shqipërisë.

Synimi i përgjithshëm i kësaj strategjie të bashkëpunimit është të kontribuojë për një demokraci

Bern, Shkurt 2018

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim (SDC)



Manuel Sager
Drejtor i Përgjithshëm

funkionale, për shërbime të përmirësuara publike dhe për një ekonomi konkurruese tregu në mbështetje të integritit evropian të Shqipërisë. Strategjia përqendrohet në katër fusha tematike që plotësojnë dhe përforcojnë njëra-tjetrën. Angazhimet e parashikuara financiare për periudhën 2018-2021 arrijnë në vlerën 105 milionë Franga Zvicerane.

Ky dokument shpjegon arsyetimin e bashkëpunimit Zvicër - Shqipëri. Bazuar në zhvillimet kontekstuale në Shqipëri, arritjet dhe përvojat e ndërhyrjeve të mëparshme, dokumenti përcakton implikimet për strategjinë e bashkëpunimit 2018-2021, ndjekur nga një kuadër përparësish dhe objektivash për periudhën në vazhdim. Dokumenti mbyllet me informacion rreth menaxhimit, monitorimit, dhe drejtimit të programit.

Strategjia e Bashkëpunimit Zviceran 2018-2021 është hartuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) në këshillim të ngushtë me institucionet qeveritare shqiptare dhe partnerët e shoqërisë civile. SDC dhe SECO të cilat përfaqësohen nga Ambasada e Zvicrës në Tiranë, bashkëpunojnë dhe bashkërendohen ngushtë për zbatimin e pjesëve përkatëse të strategjisë.

Jemi besimplotë që synimet dhe përparësitë e përcaktuara në këtë strategji janë veçanërisht me vlerë për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë dhe mirëqenien e popullit të saj.

Sekretariati i Shtetit për
Çështjet Ekonomike (SECO)



Marie-Gabrielle Ineichen-Fleisch
Sekretare e Shtetit

Table of Contents

Parathënie	1
Table of Contents	2
Përmbledhje Ekzekutive	3
1. Konteksti i vendit.....	5
2. Politika e jashtme zvicerane në Shqipëri dhe konteksti i donatorëve.....	8
3. Arritjet dhe mësimet e nxjerra për periudhën 2014-2017	9
4. Implikimet për Strategjinë e re të Bashkëpunimit 2018-2021	13
5. Orientimi strategjik dhe përparësitë zvicerane për 2018-2021	14
6. Menaxhimi dhe zbatimi i programit.....	17
7. Drejtimi Strategjik.....	18
Shtojca 1: Përmbledhje e rezultateve 2018-2021 (Portofoli zviceran)	19
Shtojca 2: Skenarët e kontekstit	20
Shtojca 3: Kuadri i rezultateve	22
Shtojca 4: Shpërndarjet indikative të buxhetit 2018-2021	31
Shtojca 5: Sistemi i monitorimit.....	32
Shtojca 6: Harta e Shqipërisë	33
Shkurtime dhe akronime.....	34

Përmbledhje Ekzekutive

Zvicra dhe Shqipëria sapo shënuan 25 vite bashkëpunim. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) ndajnë përgjegjësinë për asistencën zvicerane në Shqipëri që prej viteve '90. Përfaqësia e integruar Zvicerane (Ambasada) fokusin kryesor e ka në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Gjatë ciklit të strategjisë së mëparshme 2014-2017, Qeveria e Zvicrës bashkëpunoi me Shqipërinë në katër fusha: (i) *demokratizimi, decentralizimi, dhe qeverisja vendore*; (ii) *zhvillimi ekonomik*; (iii) *infrastruktura urbane dhe energjia*; dhe (iv) *shëndetësia*. Shpenzimet e përgjithshme gjatë kësaj periudhe arritën në rreth 83.7 milionë CHF. Në përgjithësi, portofoli i ndërhyrjeve zvicerane rezultoi se ishte në përputhje me nevojat e vendit, dhe prodhoi rezultate dhe ndryshime të prekshme në nivel sistemi dhe individësh. Qasja këmbëngulëse e Zvicrës dhe bashkërendimi me modalitetet e BE-së u konsideruan si të vlefshme.

Interesi ndërkombëtar për tranzicionin e Shqipërisë vazhdon. BE-ja është padyshim kontribuesi më i madh i granteve. Gjermania, Turqia, Zvicra dhe Italia ishin donatorët dypalësh më të mëdhenj gjatë periudhës 2012-2015. Strategjitë dhe politikat e Shqipërisë për zhvillim kombëtar, reformat që lidhen me anëtarësimin në BE, Njoftimi Federal për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Zvicrës dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara sigurojnë kuadrin e përgjithshëm për Asistencën Zyrtare Zvicerane për Zhvillim në Shqipëri. Ambasada Zvicerane ka marrëdhënie të ngushta pune me BE-në dhe donatorë të tjerë, ndër të tjera edhe përmes Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave që drejtohen nga qeveria. Gjatë periudhës në vazhdim do të identifikohen mundësi shtesë për të punuar me sektorin privat, me qëllim arritjen e rezultateve me rëndësi për zhvillimin.

Strategjia e re e bashkëpunimit 2018-2021 do të vazhdojë përpjekjet e mëparshme për të ruajtur dinamikën dhe cilësinë e reformave të vendit dhe zbatimit të tyre në përfitim të popullit shqiptar. Zvicra do të vijojë të punojë në katër fushat ekzistuese të ndërhyrjes. Ajo do të mbështesë përpjekjet për (i) promovimin e një *sistemi demokratik qeverisjeje funksional* dhe përfshirës bazuar në sundimin e ligjit; (ii) përforcimin e *ritjes ekonomike të qëndrueshme* dhe përfshirëse që krijon punësim; (iii) përmirësimin e *infrastrukturës urbane dhe sektorit të energjisë*; dhe (iv) fuqizimin e sistemit të *shëndetësisë*.

Krahasuar me strategjinë e mëparshme, planifikohen ndryshimet e mëposhtme në portofol:

- Mbështetje për autoritetet legjislativ të qeverisë në nivel vendor dhe kombëtar, si dhe për ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen civile
- Përqendrim më i madh në arsimin dhe formimin profesional
- Tërheqja graduale nga ndërhyrjet për sigurinë e digave dhe prezantimi i veprimtarive për efikasitetin e energjisë me bashkitë
- Rritja e përqendrimit në promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve jo-ngjyeshme

Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të kontribuojë për një demokraci funksionale, për shërbime publike të përmirësuara, dhe për një ekonomi tregu konkurruese dhe përfshirëse në mbështetje të integritetit evropian të Shqipërisë. Ajo përqendrohet në katër objektiva:

- Popullata përfiton nga institucione përfshirëse, të efektshme dhe demokratike
- Rritja e qëndrueshme siguron më shumë punësim dhe mundësi më të mira biznesi për të gjithë
- Popullata përfiton nga shërbimet e infrastrukturës bashkiake me cilësi të lartë dhe nga furnizimi dhe efikasiteti i përmirësuar të energjisë
- Një popullsi e mirë-informuar dhe e angazhuar në shëndetësi përfiton nga shërbimet e efektshme dhe cilësore të kujdesit shëndetësor parësor

Qeverisja e mirë është një nga gjashtë objektivat e Strategjisë Kombëtare të Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI). Fusha e *qeverisjes demokratike* përbën programin më të madh të portofolit zviceran. Ndërhyrjet do të mbështesin vijimin e suksesshëm të reformave në fushat e decentralizimit, zhvillimit rajonal, përfshirjes sociale, administratës publike dhe menaxhimit të financave publike (MFP) në nivel vendor. Ato do të mbështesin njësitë e qeverisjes vendore, organet legjislativ kombëtare dhe vendore, shoqërinë civile, dhe veçanërisht grupet e përjashtuara, në mënyrë që vendimmarrja të jetë më pranë njerëzve dhe të përforcohet pjesëmarrja e tyre gjë që do të sjellë shërbime më përfshirëse dhe më efektive.

Shqipëria u ngrit në statusin e vendeve me të ardhura mbi mesataren në vitin 2009, por mbetet një nga vendet më të varfra në Europë. Në fushën e *zhvillimit ekonomik dhe punësimit*, Zvicra do të mundësojë rritje dhe punësim të qëndrueshëm dhe përfshirës,



Numri i turistëve që vizitojnë zonat malore të Shqipërisë është në rritje.

duke nxitur njëkohësisht stabilitetin makroekonomik, duke lehtësuar krijimin e vendeve të punës dhe të të ardhurave, si dhe duke zhvilluar aftësitë e orientuara nga tregu. Programi zviceran do të ndihmojë për të forcuar qeverisjen ekonomike duke mbështetur institucione financiare publike kombëtare kryesore për përmirësimin e MFP-së, dhe rregullimit e mbikëqyrjes së sektorit financiar. Ajo do të trajtojë sfidat kyçe të sektorit privat, veçanërisht ato në bujqësi, TIK dhe turizëm, dhe duke konsideruar shkallën e lartë të papunësisë tek të rinjtë, ajo do të rrisë mbështetjen në arsimin dhe formimin profesional (AFP), të orientuar nga tregu i punës.

Ndërhyrjet zvicerane në fushën e *infrastrukturës urbane dhe energjisë* do të rezultojnë në ofrim më të mirë të shërbimeve bashkiake, me përfitim për shëndetin publik dhe mjedisin. Shërbimet e ujësjellësit, kanalizimeve dhe menaxhimi imbetjeve janë të kufizuara nga përgjegjësi të paqarta dhe nga financimi i brendshëm i pamjaftueshëm. Mbështetja për infrastrukturën dhe zhvillimi e kapaciteteve të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve duhet ta përmirësojnë këtë situatë dhe të përshpejtojnë reformat. Reformat e kohëve të fundit në sektorin energjetik kanë pasur sukses, por performanca e sistemit energjetik në Shqipëri mbetet akoma në rrezik. Ndihma zvicerane do të mbështesë diversifikimin e burimeve të energjisë. Do të ketë furnizim të besueshëm të energjisë me burime të reja dhe ajo do të përdoret me efikasitet.

Shërbimet shëndetësore në Shqipëri vuajnë nga deficitet strukturore të sistemit dhe nga një buxhet i ulët. Portofoli zviceran promovon institucione

efikase të kujdesit shëndetësor parësor (KSHP), që ofrojnë më shumë shërbime me cilësi më të lartë dhe me efikasitet, në mbështetje të SKZHI-së dhe Strategjisë Kombëtare për Shëndetësinë 2017-2020. Përveç kujdesit shëndetësor parësor të përmirësuar, Prortofoli zviceran do të japë ndihmesë për një status të përmirësuar të shëndetit, duke zbatuar veprimtari për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve jo-ngjitëse (SJN).

Temat e qeverisjes dhe gjinisë do konsiderohen tej-përshkuese. Qeverisja do të integrohet nëpërmjet promovimit të masave kundër korrupsionit dhe nëpërmjet futjes së konceptit të 'përfshirjes' në sferat shoqërore, ekonomike dhe politike. Projektet zvicerane rreken të promovojnë një politikëbërje të ndjeshme ndaj çështjes gjinore, rritje të përfaqësimit të grave në proceset vendimmarrëse, uljen e barrës së punës së papaguar për gratë, dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në arsim dhe në tregun zyrtar të punës. Për më tepër, do të trajtohen edhe shkaqet thelbësore të migrimit. Migrimi dhe zhvillimi do të trajtohen aty ku është e nevojshme. Projektet do të shqyrtojnë veçanërisht mundësitë për të përfituar nga diaspora shqiptare, remitancat dhe emigrantët e ritkhyer. Gjithashtu, programi do të marrë në konsideratë edhe masa për të trajtuar të shkuarën komuniste të Shqipërisë.

Zvicra planifikon të shtojë buxhetin e saj për bashkëpunimin me Shqipërinë. Për periudhën 2018-2021, angazhimet e planifikuara arrijnë në vlerën e 105 milionë CHF ose mesatarisht 26.25 milionë CHF në vit, një rritje prej 19% krahasuar me strategjinë e mëparshme.

1. Konteksti i vendit

Progres gradual dhe i vazhdueshëm i reformave

Shqipëria është zhvilluar me hapa të shpejtë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit. Në vitin 1991, regjimi komunist u shkri dhe Shqipëria nisi tranzicionin e saj nga një prej regjimeve më shtypëse dhe të izoluar drejt demokracisë.

Në pak më shumë se 25 vite, vendi ka bërë progres mbresëlënës. Me gjithë sfidat e të shkuarës, qeveritë janë ndërruar relativisht paqesisht. Me përjashtim të trazirave civile në vitin 1997, gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit nuk ka pasur tensione madhore shoqërore, kulturore, apo fetare. Reformat kanë ecur, përfshirë përmirësimet të rëndësishme në sektorë si administrata territoriale dhe publike, PFM, energjia dhe drejtësia.

Përgjithësisht Shqipëria ka kontribuar për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Ajo u anëtarësua në NATO në vitin 2009 dhe iu akordua statusi i vendit kandidat për BE në vitin 2014. Në dhjetor 2016, Komisioni Europian rekomandoi hapjen e negociatave të anëtarësimit me kusht që të përparojë reforma në drejtësi.

Në Shqipëri nuk ka shenja të lodhjes nga tranzicioni. Aspirata për anëtarësim në BE është një vizion i përbashkët për shumicën e shqiptarëve, për qeverinë dhe për të gjitha partitë kryesore. Pritet që reformat të vijnë, megjithëse pritët të shihet se me çfarë ritmi. Për shembull, decentralizimi ka përparuar mirë. Organeve të qeverisjes vendore të ngritura rishtas i janë deleguar më shumë funksione. Atyre u është dhënë një kuadër i ri ligjor për funksionimin, organizimin dhe financat vendore, dhe më shumë autonomi financiare dhe fiskale. Kështu qeveritë vendore janë në gjendje të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve në masën e lejuar nga burimet e tyre të kufizuara dhe kapacitetet e pakta. Por ndryshimi i vërtetë do të varet nga mbështetja e qeverisë qendrore me më shumë fonde (transferta dhe krijimi i të ardhurave të veta nga qeverisja vendore) dhe nga modernizimi dhe ngritja e profesionalizmit të shërbimeve bashkiake në perspektivën afatmesme dhe afatgjatë. Një sfidë tjetër është depolitizimi i administratës publike.

Është arritur një konsensus i përbashkët për nevojën e zbatimit të reformave me ndjeshmëri të lartë në drejtësi dhe të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që janë gjerësisht të përhapur. Megjithatë, rezistenca e atyre që përfitojnë nga



Fëmijë pranë sheshit kryesor në Has në veri të Shqipërisë

gjendja aktuale po dëmton procesin e reformës dhe mund të vonojë fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Kultivimi i kanabisit dhe trafikimi i lëndëve narkotike janë rreziqe kryesore për tranzicionin dhe prosperitetin afatgjatë. Akuzat për lidhje midis zyrtarëve qeveritarë dhe krimit të organizuar janë shtuar gjatë viteve të fundit. Në sajë të përmirësimeve të fundit të kuadrit ligjor për kontrollin e historikut penal të zyrtarëve publik, infiltrimi në politikë nga krimi i organizuar do të jetë më i vështirë. Megjithatë, pushteti dhe paratë e krimit të organizuar mbeten faktorë të konsiderueshëm dhe me ndikim.

Në përgjithësi, perspektiva e anëtarësimit të Shqipërisë në BE mbetet pozitive. Por, duke marrë në konsideratë faktorët e brendshëm të përmendur më lart dhe lodhjen aktuale nga zgjerimi në BE, procesi i anëtarësimit mund të zgjasë edhe dhjetë vite të tjera.



Të rinj pjesëmarrës në një aktivitet në Cakran, Fier.

Hapat e parë të pjesëmarrjes së shoqërisë civile

Qytetarët shqiptarë kanë nivel të ulët besimi në institucionet shtetërore, veçanërisht te Kuvendi, dhe hezitojnë të përfshihen në dialog politik. Nga ana tjetër, shoqëria civile shqiptare po bëhet një pjesëmarrëse disi më aktive, veçanërisht në zonat urbane dhe në lidhje me të drejtat e grave. Thirrjet për më shumë transparencë dhe llogaridhënie nga ana e elitës politike po shtohen. Media është e kapur midis interesave politike dhe ekonomike dhe nuk është aspak e pavarur. Pasojat ligjore dhe kërcënimet ndaj gazetarëve janë kthyer në realitet. Platformat në internet sigurojnë mundësi për gazetari cilësore.

Një nga vendet më të varfra të Europës me perspektivë për rritje ekonomike të moderuar

Pas daljes nga sundimi komunist që zgjati 45 vite, Shqipëria nisi një periudhë tranzicioni të shpejtë nga një ekonomi me planifikim të centralizuar drejt një ekonomie të orientuar nga tregu. Në sajë të rritjes së nxitur nga konsumi i brendshëm, Shqipëria arriti statusin e vendit me të ardhura mbi mesataren në vitin 2009.

Kriza financiare e vitit 2008 shkaktoi një ngadalësim të theksuar në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Zgjerimi i kufizuar i ekonomisë që prej këtij momenti është nxitur nga eksportet dhe stimujt fiskalë të qeverisë, gjë që ka krijuar një borxh të madh publik. Si rrjedhojë, borxhi publik është i lartë (71% e PBB-së në fund të vitit 2016), por me një prirje të ngadaltë drejt uljes në sajë të reformave për rritjen e stabilitetit makroekonomik dhe fiskal.

Bujqësia (21%), tregtia dhe shërbimet (18%) dhe industria (13%) janë kontribuesit më të mëdhenj në PBB. Tekstilet, këpucët, mineralet dhe materialet e ndërtimit përbëjnë volumet më të mëdha të eksportit. Biznesi përballlet me sfida për shkak të zbatimit të dobët të ligjit, një mjedisi rregullator të komplikuar dhe mospërputhjeve të theksuara të aftësive në tregun e punës.¹ Ekonomia informale është pakësuar, por vlerësohet ende në rreth 30% të PBB-së. Papunësia vazhdon të mbetet e lartë (zyrtarisht 16% në 2016), me pjesëmarrje të ulët të femrave me vetëm 57% dhe shkallë të lartë papunësie te të rinjtë (15-29 vjeç), prej 30%. Sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011, 8,300 romë² jetojnë në Shqipëri (0.3% e popullsisë). Megjithatë, shoqatat rome vlerësojnë se shifrat e sakta janë rreth 100.000, nga të cilët rreth 16.000 konsiderohen si grup i cënueshëm. Shkalla e punësimit për romët mbetet e ulët për shkak të mungesës së kualifikimeve arsimore dhe përjashtimit social-ekonomik.

Migrimi për punësim drejt Europës Perëndimore ka rënë krahasuar me majat e arritura në vitin 2015, por vazhdon të ndikojë kryesisht të rinjtë në moshë madhore dhe mbetet ende një shqetësim. Si pasojë e këtij fakti dhe shkallës së ulët të lindjeve, popullsia shqiptare do të plakët shpejt, duke vënë nën tryzni sistemin e mirëqenies sociale. Shqipëria nuk është pikë mbërritjeje apo vend tranzit për dyndje të larta emigrantësh.

1. Shqipëria është në vendin e 58-të nga 190 ekonomi në Indeksin "Të Bësh Biznes" të Bankës Botërore për vitin 2017.

2. Termi romë përfshin gjithashtu edhe grupe të tjera pakicash si egjiptianët dhe ashkalit.

Varfëria ndikohet nga disa prirje ekonomike dhe shoqërore. Pasi u përgjysmua në vitin 2008 duke kapur vlerën 12%, varfëria relative ka mbetur në kuotën 15% dhe varfëria absolute në kuotën 2% (me rritje nga 1.2% në vitin 2008). Marrja e masave të synuara mirë mund të sjellë reduktimin e shkallës së varfërisë dhe pabarazisë midis zonave urbane dhe rurale, si dhe grupeve të ndryshme të popullsisë. Megjithatë, do të vazhdojë të ketë zona varfërie. Për momentin, Shqipëria mbetet një nga vendet më të varfra të Europës. Në vitin 2016, PBB për frymë ishte 4.147 USD.³ Gratë janë më të ekspozuara ndaj varfërisë ekstreme, veçanërisht gratë që janë kryefamiljare.

Në të ardhmen, perspektiva e rritjes së moderuar të ekonomisë me 3-4% do të sjellë vetëm përfitime të kufizuara përsa i përket punësimit dhe të ardhurave. Për më tepër, Shqipëria do të përballet me sfidën e zëvendësimit të kontribuesve aktualë me rëndësi si Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) dhe projekti i hidrocentralit të Devollit, kur këto projekte të kenë përfunduar.

Akses i pabarabartë në shërbime publike

Disponueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike po përmirësohen. Megjithatë, aksesin në këto shërbime nuk është gjithëpërfshirës. Popullsia rurale dhe gratë janë veçanërisht në disavantazh, ashtu si edhe të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe të varfrit. Sistemi shëndetësor vuan nga probleme strukturore dhe nga një buxhet i pakët. Familjeve u duhet të bëjnë pagesa nga xhepi për kujdesin shëndetësor, duke përfshirë kështu shumë prej tyre që nuk kanë mundësi t'i bëjnë këto pagesa. Përhapja e sëmundjeve jo-ngjitëse ka pësuar një rritje të fortë. Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare për Shëndetin në Shqipëri e miratuar në vitin 2017, është një instrument i rëndësishëm për promovimin e efektshëm të shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve, si dhe për një financim më të qëndrueshëm të shëndetësisë. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror po përmirësohet. Grupet e cënueshme dhe të marginalizuara pritet të përfitojnë gjithmonë e më shumë akses të barabartë dhe dinjitoz.

Furnizimi me ujë në Shqipëri ka shënuar progres: 79% e popullsisë urbane furnizohet me ujë. Krahasimisht, vetëm 49% e kësaj popullsie është pjesë e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza. Me gjithë forcimin e shërbimeve të ndërmarrjeve publike dhe investimeve të konsiderueshme në

infrastrukturë, zgjerimi i mbulimit me ujë dhe kanalizime kufizohet nga zbatimi i ngadaltë i reformave, përgjegjësitë e paqarta dhe financimi i pamjaftueshëm vendas. Në sektorin e mbetjeve të ngurta vihet re progres i kufizuar, që ndikon në mjedis dhe në shëndetin publik. Pa mbështetje nga jashtë, menaxhimi i mbetjeve do të vijojë të mbetet një çështje e neglizhuar. Me gjithë retorikën pozitive, çështjet mjedisore akoma konsiderohen si çështje me përparësi të ulët.

Reforma të suksesshme në sektorin e energjisë, por performanca mbetet në rrezik

Reformat e kohëve të fundit në sektorin e energjisë kanë pasur sukses të madh. Shqipëria u rendit e 25-ta nga 127 vende në Raportin e Indeksit të Performancës së Arkitekturës Botërore të Energjisë 2017, duke e renditur më lart se të gjitha vendet e Europës Juglindore. Progresi në zhvillimin e sektorit të gazit dhe veçanërisht ndërtimi i Gazsjellësit Trans



Diga e hidrocentralit të Fierzës mbi lumin Drin.

Adriatik (TAP) janë me rëndësi për rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe diversifikimin e energjisë në të ardhmen. TAP është një investim strategjik që e lidh Shqipërinë me rrjetet europiane të gazit, duke forcuar kështu pozicionin e Shqipërisë si një partner i besueshëm për ekonominë europiane. Megjithatë, ka gjasa që furnizimi me energji të vijojë të mbetet në rrezik për shkak të cënueshmërisë nga thatësitrat, diversifikimit të ngadaltë të burimeve të energjisë dhe performancës së dobët financiare. Efiçensa e ulët e energjisë ofron mundësi të konsiderueshme për përmirësime.

3. <http://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>.

2. Politika e jashtme zvicerane në Shqipëri dhe konteksti i donatorëve



Shkëmbimet e nivelit të lartë midis Zvicrës dhe Shqipërisë janë intensifikuar.

Bashkëpunimi me Europën Lindore është një komponent integral i politikës së jashtme dhe ekonomike të Zvicrës. Zvicra mbështet vendet ish-komuniste në Europën Lindore, si qeveritë, ashtu edhe shoqëritë e tyre civile, në rrugëtimin drejt demokracisë dhe ekonomisë sociale të tregut. Asistenca e Zvicrës për tranzicionin në rajon bazohet në interesin reciprok për zhvillim social dhe ekonomik përfshirës, stabilitet, siguri dhe integrim europian. Ajo motivohet nga solidariteti i Zvicrës me të varfrit dhe të përjashtuarit dhe nga respekti për të drejtat e njeriut. Me gjithë progresin e shënuar, mbeten akoma shumë reforma për t'u ndërmarrë në fusha si decentralizimi, sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe shërbimet publike. Për më tepër, asistenca për tranzicionin krijon mundësi ekonomike për Zvicrën.

Angazhim i vazhdueshëm ndërkombëtar

Interesi ndërkombëtar për tranzicionin e Shqipërisë vazhdon. Në përgjithësi, prurjet nga Asistenca Zyrtare për Zhvillim (ODA) në Shqipëri kanë mbetur përgjithësisht të pandryshuara gjatë viteve të fundit por me pak lëvizje nga donatorët tradicionalë tek ata jo tradicionalë. Gjermania, Turqia, Zvicra dhe Italia ishin donatorët dypalësh më të mëdhenj në periudhën 2012-2015. Në vitin 2015 ODA për Shqipërinë ishte gjithsej 334 milionë⁴ USD ose 3.5% e PBB-së.

BE-ja është padyshim kontribuesi më i madh i granteve. Axhenda e zhvillimit për shumë sektorë përcaktohet në sajë të këtij fakti dhe aspiratave të Shqipërisë për anëtarësim në BE. Organizatat shumëpalëshe më aktive janë Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Banka Botërore (BB), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dhe Këshilli i Europës (KE).

Qeveria e Shqipërisë ka ngritur katër 'Grupe të Integruara të Menaxhimit të Politikave' për bashkërendimin ndërsektorial lidhur me menaxhimin e integruar të ujërave, qeverisjen e mirë dhe administratën publike, punësimin dhe sektorin social, dhe konkurrueshmërinë dhe inovacionin. Për të garantuar suksesin e projekteve të financuara nga Zvicra është i domosdoshëm kontributi i qeverisë shqiptare për zbatimin e tyre me efikasitet. Zvicra bashkëdrejton dy nëngrupe tematike për qeverisjen vendore dhe AFP-në. Në përgjithësi, Zvicra ka luajtur rol proaktiv në dialogun e politikave. Në sajë të volumit të ODA-s dhe Përfaqësisë Zvicerane të integruar, Zvicra ka pasur një ndikim pozitiv në politikat shqiptare.

Mbi 25 vite të pranisë së Zvicrës në Shqipëri

SDC dhe SECO ndajnë përgjegjësitë për asistencën zvicerane në Shqipëri që prej vitit 1992, pra që prej fillimit të tranzicionit të vendit drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Qasja e paanshme e Zvicrës në marrëdhëniet e jashtme dhe roli plotësues për bashkëpunimin me BE kanë qenë me vlerë.

Strategjitë dhe politikat e zhvillimit kombëtar në Shqipëri, reformat e lidhura me anëtarësimin në BE, Njoftimi Federal për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Zvicrës dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të Kombeve të Bashkuara sigurojnë kuadrin e përgjithshëm për planifikimin dhe zbatimin e ODA-s zvicerane në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, bashkëpunimi me Shqipërinë gjatë periudhës 2018-2021, do të japë kontribut për shtatë objektiva strategjikë të Njoftimit Federal 2017-2020.⁵

4. Sipas OECD/DAC.

5. Njoftimi për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Zvicrës 2017-2020: "<https://www.eda.admin.ch/deza/en/home/sdc/strategy/legalbases/message-international-cooperation-2017-2020.html>".

3. Arritjet dhe mësimet e nxjerra për periudhën 2014-2017

Demokratizimi, decentralizimi dhe qeverisja vendore

Arritjet kyçe
<ul style="list-style-type: none">▪ Krijimi i një Këshilli Konsultativ në vitin 2017, në të cilin njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale konsultohen lidhur me vendime kombëtare, thekson rolin e ri dhe të fuqizuar të njësisë të qeverisjes vendore paralelisht me përparimin e decentralizimit.▪ Zyrat e Integruara të Shërbimit me Një Ndalesë, në 10% të bashkive shqiptare, sipas një modeli që mund të zbatohet në të gjithë vendin, u ofrojnë qytetarëve shërbime administrative moderne dhe rrisin besueshmërinë e qytetarëve tek njësitë e qeverisjes vendore.▪ Portalët në internet me të dhëna financiare bashkiake nga të gjitha 61 bashkitë janë të aksesueshëm dhe kontribuojnë për transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes vendore.▪ 42 projekte për shoqëri të civilë të financuar nga Zvicra kanë përmirësuar pjesëmarrjen, llogaridhënien dhe transparencën e bashkive.▪ 320 familje rome (25% e familjeve rome në katër qytetet e synuara) fituan akses në formim profesional dhe mundësi për krijimin e të ardhurave.

Zvicra ka mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në përshejtimin dhe zbatimin e plotë të axhendës së decentralizimit. Në kuadrin e proceseve me ritëm të shpejtë të reformës territoriale dhe administrative, ekspertiza zvicerane mbështeti hartimin e kufijve të rinj bashkiakë për të gjithë vendin. Zvicra gjithashtu kontribuoi për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrin të ri ligjor për decentralizimin administrativ dhe fiskal dhe zhvillimin rajonal. Ajo promovoi dhe mbështeti ndërtimin e një administrate publike të bazuar mbi meritën në nivel kombëtar si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore profesionale në nivel vendor. Një program i financuar nga Zvicra modernizoi ofrimin e shërbimeve administrative nëpërmjet Zyrate të Integruara me Një Ndalesë, që ofrojnë shërbime elektronike për qytetarët dhe lidhin bashkinë qendër me njësitë administrative në periferitë e bashkive. Falë ligjit të ri për financat vendore dhe përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve, menaxhimi i financave vendore të bashkive u fuqizua në të gjithë vendin. Disa bashki në veri të vendit përfituan gjithashtu nga mbështetja e drejtpërdrejtë për menaxhimin financiar dhe të mbetjeve, si dhe zgjeruan mbulimin me ofrimin e shërbimit.

Mbështetja financiare zvicerane ndihmoi gjithashtu me krijimin e një mekanizmi të institucionalizuar këshillimi, Këshilli Konsultativ, për diskutimin e çështjeve ndërmjet nivelit vendor, rajonal dhe qendror, i pari i llojit të tij në Shqipëri dhe që konsiderohet si një arritje për zhvillimin e demokracisë vendore.

Në bashkëpunim me OKB-në në Shqipëri, është krijuar një kuadër i shëndoshë politikash për përfshirjen sociale në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e BE-së. Në katër rajone të synuara, u rrit në mënyrë të qëndrueshme aksesin në arsim për 40% të fëmijëve romë dhe përfituan nga aksesin në kujdes social, arsim, apo mundësi për krijimin e të ardhurave 1,300 familje (25% e totalit të familjeve rome të synuara).

Zvicra ka promovuar aksionet civile në Shqipëri, veçanërisht në lidhje me funksionimin e qeverisë vendore. Palët e interesit të shoqërisë civile dhe media të mbështetura nga Zvicra mobilizuan me sukses



Gra politike nga Shqipëria e veriut të mbështetura nga programi për decentralizimin.

projekte të qytetarëve për më shumë transparencë dhe llogaridhënie. Më mbështetjen zvicerane, Aleanca e Grave Deputete, një rrjet ndërpartiak me gra deputete në nivel vendor dhe qendror, bëri lobim për më shumë barazi gjinore dhe përfshirje.

Mësimet e nxjerra: Axhenda e decentralizimit ka ecur përpara në mënyrë mbresëlënëse dhe me ritëm të shpejtë në Shqipëri. Zvicra mund të japë një kontribut domethënës si rrjedhojë e përvojës së gjatë në nivelin vendor. Nevojitet më shumë mbështetje për të konsoliduar reformat dhe për të forcuar institucionet demokratike. Prandaj, përveç mbështetjes aktuale, parlamenti dhe këshillat bashkiakë do të fuqizohen në funksionet e tyre të mbikëqyrjes, përfaqësimit dhe ligjvënësë. Kjo shkon paralelisht me mbështetjen e vazhduar për shoqëri të civilë dhe nismat e medias në kuadrin e përfundimit të demokracisë.

Zhvillimi ekonomik:

Arritjet kyçe

- U hartua një model i ri për parashikimin makroekonomik me Ministrinë e Financave, që siguron një bazë për politikëbërjen bazuar në fakte.
- Programe të reja kompjuterike mundësojnë regjistrim dhe raportim më të mirë të të dhënave për borxhin publik.
- Lehtësimi i procedurave tatimore për biznesin.
- Përmirësim i kuadrit për zgjidhjen e borxhit për kompanitë .
- Aftësi të përmirësuara dhe investime shtesë të sektorit privat në TIK, turizëm dhe agro-përpunim prej 6,4 milionë Euro.
- 6.276 të rinj të punësuar, që përbën 7,6% të rinisë së papunë të regjistruar.
- Rritje e prodhimeve organike dhe kuadër i përmirësuar ligjor, i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, për bujqësinë organike.



Studentë të shkollës profesionale për hoteleri dhe turizëm në Vlorë.

Gjatë periudhës 2014-2017, Zvicra mbështeti stabilitetin makroekonomik, zhvillimin e sektorit privat dhe punësimin e të rinjve. Në nivelin makroekonomik, me mbështetjen e Zvicrës, Ministria e Financave krijoi një model parashikimi makroekonomik për politikëbërjen e bazuar në fakte. Banka e Shqipërisë përmirësoi kapacitetet e veta për hartimin e politikave monetare, që ka kontribuar për një kthim gradual të inflacionit drejt vlerës së synuar. Sisteme të reja kompjuterike ndihmojnë qeverinë e Shqipërisë të menaxhojë dhe të raportojë më mirë mbi borxhin publik.

Nismat e bashkëpunimit zviceran kanë përmirësuar gjithashtu edhe aftësinë tërheqëse të Shqipërisë për të bërë biznes, p.sh. u vendos një sistem transparent për çmimet e transferueshme, ndërsa u reduktuan kostot dhe koha që nevojitet për pagesën e detyrimeve tatimore. Për më tepër, regjimi i falimentimit dhe raportimi financiar i korporatave janë përmirësuar konsiderueshëm.

Nismat për zhvillimin e sistemit të tregut, të financuara nga Zvicra, kanë krijuar punësim për 900

të rinj në sektorët premtues të TIK-ut, turizmit dhe agro-përpunimit, me përfitime të barabarta si për burrat ashtu edhe për gratë. 5,376 vajza dhe djem fituan vende pune falë një sistemi të përmirësuar publik dhe privat për bashkërendimin e vendeve të punës. Në të dy kategoritë, pjesëmarrja e femrave ishte 52%. Cilësia dhe rëndësia e arsimit profesional, veçanërisht në katër shkolla të ndihmuara, u përmirësuan falë përfshirjes më të madhe nga sektori privat. Si rrjedhojë, shkalla e regjistrimit në to u rrit konsiderueshëm.

Mësimet e nxjerra: Ndërkohë që Shqipëria ka arritur stabilitet të konsiderueshëm makroekonomik, vendi përballet akoma me sfida për të ruajtur një rritje të qëndrueshme që lejon krijimin gjithëpërfshirës të vendeve të punës. Do të nevojiten përpjekje të mëtejshme për të mbështetur rritjen e produktivitetit, si përmes përmirësimit të kuadrit rregullator që stimulon investimet, ose përmes njohurive, inovacionit dhe teknologjisë. Nismat plotësuese zvicerane, që mbështesin rritjen e sektorit privat, sistemin e bashkërendimit të vendeve të punës dhe zhvillimin e aftësive, do të shtohen.

Infrastruktura urbane dhe energjia:

Arritjet kyçe

- 175,000 qytetarë në Shkodër dhe Lezhë përfituan nga furnizimi me ujë 24 orë në ditë dhe nga një sistem i përmirësuar kanalizimesh.
- Ri-negocimi i suksesshëm i marrëveshjes me Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP) solli edhe 80 milionë Euro të tjera përfitim për Shqipërinë.
- Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit të Gazit (AlbGas) u ngrit dhe u forcua me kapacitete.
- U hartuan aktet nënligjore për metodologjinë e tarifave të gazit.
- U mundësua ngritja e kapaciteteve për 140 ekspertë teknikë të ministrive të ndryshme, të përfshirë në realizimin e TAP-it për tema lidhur me gazin.

Mbështetja zvicerane për përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve dha kontribut për akses të përmirësuar në shërbime të sigurta, të shëndetshme për mjedisin, të besueshme dhe të përbalueshme në Shkodër dhe në Lezhë, që përbëjnë 14% të popullsisë urbane të Shqipërisë. Kënaqshmëria e qytetarëve për shërbimet në këto dy qytete u rrit me më shumë se 50%.

Përmes përmirësimit të sigurisë së digave, u rrit besueshmëria dhe qëndrueshmëria e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike që përbën 95% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Shqipëri. Një pikë për t'u theksuar në kuadrin e rritjes së sigurisë së energjisë nëpërmjet diversifikimit të burimeve vendase, ishte mbështetja dhënë qeverisë së Shqipërisë për fillimin e suksesshëm të ndërtimit të TAP-it. TAP është projekti më i madh infrastrukturor në Shqipëri dhe një shtysë e rëndësishme për transformimin dhe rritjen ekonomike. Zvicra siguroi 6 milionë CHF për forcimin e kapaciteteve të shtetit shqiptar në zhvillimin dhe menaxhimin e sektorit të gazit. Me mbështetjen e Zvicrës, qeveria mundi të rinegocionte kontratën

e saj me TAP-in, duke përfituar kështu rreth 80 milionë Euro shtesë, kryesisht në formën e pagesave të ardhshme tatimore dhe investimeve në kuadrin e përgjegjësisë sociale të korporatës.

Mësimet e nxjerra: Gjatë dy dekadave të fundit, Zvicra ka dhënë kontribut të qenësishëm për zhvillimin e sistemit të furnizimit me energji në Shqipëri, përfshirë këtu edhe sigurinë e digave. Për të vijuar përfitimin nga përvoja dhe reputacioni i mirë në këtë sektor, angazhimi zviceran do të përqendrohet te kërkesa për energji, duke përmirësuar efikasitetin e energjisë.



Puna në vazhdim për instalimin e Gazsjellësit Trans Adriatik 100 km në jug të Tiranës.

Shëndetësia:

Arritjet kyçe

- Në Universitetin e Tiranës u hap një program Masteri Profesional në Menaxhimin Shëndetësor në vitin 2017.
- Edukimi i vazhdueshëm mjekësor mbulon 100% të profesionistëve në mjekësi, përfshirë 12,000 infermierët e certifikuar (90% gra).
- Rritje e ndërgjegjësimit për shëndetin falë më shumë se 250 seancave të edukimit shëndetësor në nivel fshati dhe shkolle, dhe strategjia e plani i ri i veprimit për promovimin e shëndetit janë gati për zbatim.
- Cilësia e shërbimeve shëndetësore është përmirësuar falë mjekëve të formuar më mirë dhe qendrave shëndetësore të rinovuara dhe të pajisura mirë, në rajonet e Fierit dhe Dibrës, që shërbejnë rreth 15% të popullsisë në Shqipëri.

Zvicra ka mbështetur sektorin e shëndetësisë në Shqipëri që prej viteve '90 dhe që prej vitit 2013 është përqendruar në kujdesin shëndetësor parësor. Kontributi ka sjellë një sërë nismash dhe inovacionesh për përmirësimin e sistemit shëndetësor në nivel vendor dhe kombëtar. Ekspertiza zvicerane ka mbështetur dhe ndikuar në mënyrë të konsiderueshme politikën dhe planin kombëtar të



Infermiere në qendrën shëndetësore të rinovuar, Cakran.

veprimit për promovimin e shëndetit të sapomiruar dhe ka kontribuar për strategjinë kombëtare të shëndetit. Ndryshimet për menaxhimin më të mirë të kujdesit shëndetësor parësor, si dhe cilësi më të mirë kujdesi përmes kapaciteteve të përmirësuar klinike u zbatuan në 15% të qendrave shëndetësore rurale. Në veçanti, bashkëpunimi midis Zvicrës dhe Ministrisë së Shëndetësisë mundësoi rinovimin dhe pajisjen e qendrave shëndetësore në Fier dhe Dibër, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve për rreth 55,000 qytetarë me shërbime me cilësi të përmirësuar.

Për më tepër, në Universitetin e Tiranës u hap për herë të parë Programi për Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor dhe u formalizua edukimi mjekësor në vazhdim për të gjithë profesionistët e mjekësisë (mjekë, infermiere, mami, dhe teknikë laborator).

Heqja e tarifave nga institucionet e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe fushatat për ndërgjegjësim më të madh shëndetësor kontribuan për përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në shërbime të KSHP-së.

Mësimet e nxjerra: Duhet bërë më shumë përpjekje jashtë sektorit shëndetësor për të luftuar rritjen e konsiderueshme të sëmundjeve jo-ngjitëse, duke promovuar shëndetin. Mbështetja teknike në nivel vendor siguron përvojë të vlefshme për mbështetjen e reformave të vendit në nivelin e politikave kombëtare.

Mësimet e përgjithshme të nxjerra:

Në përgjithësi, katër fushat e bashkëpunimit zviceran rezultuan me rëndësi, u bazuan në pikat e forta të Zvicrës dhe arritën rezultate dhe ndryshime të prekshme në nivel sistemi dhe individësh. Në mënyrë të veçantë, duhet të theksohen *mësimet e përgjithshme të nxjerra* të renditura më poshtë:

- Kapacitetet: Duke konsideruar kapacitetet përgjithësisht të kufizuara të institucioneve shtetërore, ngritja e kapaciteteve është një mënyrë thelbësore për angazhim. Megjithatë, ndërhyrja e konsiderueshme e politikës në shërbimet publike kufizon impaktin dhe kjo thekson nevojën për reforma në administratën publike.
- Përfaqësim i përbashkët: Qasja me një zë të unifikuar nga ana e Përfaqësimit të integruar Zviceran për trajtimin e çështjeve politike dhe ekonomike dhe bashkëpunimin për zhvillim, përmirësojnë kuptueshmërinë e kontekstit, qasjen tek vendimmarrësit dhe shtysat ndaj tyre.

4. Implikimet për Strategjinë e re të Bashkëpunimit 2018-2021

Strategjia e Bashkëpunimit 2018-2021 do të vijojë përpjekjet e mëparshme për të ruajtur dinamikën dhe cilësinë e reformave të vendit dhe zbatimit të tyre në përfitim të popullit shqiptar.

Bazuar në zhvillimet e parashikuara të kontekstit (shih shtojcën 2), prioritetet e Shqipërisë⁶, kërkesat e BE-së për anëtarësim, Njoftimi Federal për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Zvicrës 2017-2020, dhe rezultatet dhe mësimet inkurajuese të nxjerra nga cikli i strategjisë së mëparshme të Zvicra do të vijojë të punojë në katër fushat tematike të ndërhyrjes. Ajo do të mbështesë përpjekjet për promovimin e një sistemi *demokratik qeverisjeje*, funksional dhe përfshirës, bazuar në sundimin e ligjit; përfundimin e *rritjes ekonomike* përfshirëse dhe të qëndrueshme që krijon punësim; përmirësimin e *infrastrukturës urbane* dhe sektorit të *energjisë*; dhe fuqizimin e sistemit *shëndetësor*.

Me qëllimin që të mbështesë përpjekjet e qeverisë për të trajtuar korrupsionin dhe kërcënimin nga krimi i organizuar që janë gjerësisht të përhapur, portofoli i ardhshëm zviceran synon të forcojë sistemin e kontrolleve dhe ekuilibrave nëpërmjet mbështetjes për institucionet legjislativ si Kuvendi i Shqipërisë dhe këshillat bashkiakë. Për më tepër, mbështetja për shoqërinë civile dhe median investigative do të vazhdojë, në kuadër të përfundimit të rolit të tyre mbikëqyrës.

Duke konsideruar që Shqipëria ka përmirësuar kapacitetin e saj për të mbledhur kapital në tregjet ndërkombëtare, shumë angazhime të qeverisë nuk kërkojnë më financim me grante. Kjo është arsyeja përse programi zviceran i bashkëpunimit do të përqendrohet në sektorët që nuk mund të financohen me hua, ose aty ku grantet zvicerane mund të sigurojnë hua. Gjithashtu do të përqendrohet në ndërhyrje sistematike, për shembull reformat që synojnë të përmirësojnë kuadrin rregullator, të cilat nuk kanë një kthim të drejtpërdrejtë të investimit.



Qytetarë duke marrë shërbime në qendrën e re me 'një ndalesë'.

Në dritën e reformave afatgjata që pritet të ndërmerren në rrugëtimin e Shqipërisë drejt integritimit evropian, Zvicra do të intensifikojë angazhimin dhe mbështetjen e saj për dialogun e politikave me pjesëmarrje, duke ndërtuar mbi historikun e mirë rezultateve dhe besueshmërinë e fituar.

Portofoli zviceran do të ndryshojë kursin nga qasja gjeografike e mëparshme që synonte rajone të varfra të caktuara, për të punuar në nivel kombëtar me sa është e mundur. Pilotimi ose trajtimi i nevojave të veçanta në zona të synuara (trajtimi i zonave të varfërisë dhe grupeve të cënueshme) do të ndërmerren me synim përshkallëzimin dhe shtrirjen e këtyre ndërhyrjeve në të gjithë vendin. Ky ndryshim në qasjen gjeografike do të shërbejë për shtimin e sinergjisë, vlefshmërisë dhe efektshmërisë së portofolit zviceran. Grupet e përjashtuara përkufizohen qartë në nivel fushe dhe projekti. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet dimensioneve të shumfishta të përjashtimit. Kur të jetë e mundur, gratë e varfra, familjet rome, personat me aftësi të kufizuara dhe rinia e papunë do të kenë përparësi për të përfituar nga mbështetja zvicerane. Buxhetet e planifikuara do të rriten me 19% duke arritur 105 milionë CHF për periudhën 2018-2021 (shih shtojcën 4). Ndërkohë që numri i projekteve do të ulet, buxhetet e projekteve të veçanta do të rriten.

6. Për shembull, SKZHI 2015-20.

5. Orientimi strategjik dhe përparësitë zvicerane për 2018-2021

Synimi i përgjithshëm i Strategjisë së Bashkëpunimit Zviceran 2018-2021 është të kontribuojë për një demokraci funksionale, shërbime publike të përmirësuara dhe një ekonomi tregu konkurruese dhe përfshirëse në mbështetje të integritimit evropian të Shqipërisë.



Studentë IT në shkollën profesionale 'Pavarësia', Vlorë.

Për të arritur këtë, Zvicra do të mbështesë Shqipërinë në katër fusha tematike (i) *qeverisje demokratike* (në përputhje me SDG 16) (ii) *zhvillim ekonomik dhe punësim* (në përputhje me SDG 8), (iii) *infrastrukturë urbane dhe energji* (në përputhje me SDG 11, SDG 7), dhe (iv) *shëndetësi* (në përputhje me SDG 3).

Qeverisja demokratike: Qeverisja e mirë është një nga gjashtë objektivat e SKZHI-së. Hipoteza e impaktit të fushës së qeverisjes demokratike është se mbështetja për njësitë e qeverisjes vendore, pushtetit legjislativ kombëtar dhe vendor, si dhe shoqërisë civile dhe grupeve të cënueshme të caktuara, rezultojnë në procese vendimmarrëse që janë më afër popullit dhe që përforcojnë pjesëmarrjen e tyre.

Fusha e *qeverisjes demokratike* përbën portofolin më të madh programor për Zvicrën, të bashkëfinancuar nga SDC dhe SECO. Gjatë ciklit të ardhshëm të strategjisë, kjo fushë do t'i nënshtrohet një ndryshimi strategjik, përfshirë ndërhyrje të reja dhe përmbylljen e disa projekteve afatgjata. Do të mbështeten zbatimi i suksesshëm i decentralizimit, zhvillimit rajonal, përfshirjes sociale, reforma në administratën publike dhe strategjitë nën-kombëtare për menaxhimin e financave publike.

Zvicra do të mbështesë institucionet ekzekutive vendore (përfshirë edhe ato rajonale), për të kryer funksionet e tyre (rezultati 1). Për këtë qëllim, ajo do të mbështesë përpjekjet për decentralizim të mëtejshëm, do të promovojë bashkëpunimin midis niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe do të forcojë njësitë e qeverisjes vendore.

Në mënyrë që të kundër-balancohet mbështetja për ekzekutivin dhe të inkurajohet një sistem kontrollesh dhe ekuilibrash, Zvicra do të nisë veprimtari për përmirësimin e performancës së organeve legjislative (rezultati 2).

Më shumë se në strategjinë e shkuar, Zvicra do të mbështesë qytetarët, përfshirë grupet e cënueshme, median dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) për të luajtur një rol aktiv në vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen demokratike (rezultati 3).

Objektivi i fushës së qeverisjes demokratike:

Populli përfiton nga institucione përfshirëse, të efektshme dhe demokratike

Rezultatet e portofolit zviceran:

- Rezultati 1 – Institucione ekzekutive me performancë të lartë: Institucione ekzekutive vendore të përgjegjshme që ofrojnë shërbime përfshirëse dhe efikase
- Rezultati 2 – Organet legjislative: Kuvendi i Shqipërisë dhe këshillat bashkiakë kryejnë më mirë funksionet e tyre mbikëqyrëse dhe përfaqësuese
- Rezultati 3 – Angazhimi qytetar: Qytetarët dhe shoqëria civile angazhohen në vendimmarrje dhe i kërkojnë llogari qeverisë.

Zhvillimi ekonomik dhe punësimi: Hipoteza e impaktit për fushën e zhvillimit ekonomik dhe punësimin është mundësia e rritjes ekonomike dhe punësimin të qëndrueshëm dhe përfshirës duke mbështetur njëkohësisht stabilitetin makroekonomik, duke trajtuar sfidat kyçe të sektorit privat dhe duke zhvilluar aftësitë e duhura të orientuara nga tregu i punës. Fusha e *zhvillimit ekonomik dhe punësimin* do të zbatohet bashkërisht nga SDC dhe SECO.

Për të nxitur stabilitetin e qëndrueshëm makroekonomik, Zvicra synon të përmirësojë më tej MFP-të në nivel kombëtar si dhe rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar (rezultati 1).

Zvicra do të shtojë mbështetjen e saj për përmirësimin e kuadrit për biznes dhe klimës së investimeve. Zvicra gjithashtu do të kontribuojë për përfundimin e ekosistemit të bizneseve start-up dhe sipërmarrjeve, për fuqizimin e konkurrueshmërisë së sektorit privat, për lehtësimin e aksesit në tregun ndërkombëtar dhe për përmirësimin e sistemeve të tregut (rezultati 2). Ndërhyrjet për zhvillim, përfshirë dialogun për politikën, pritet të krijojnë dhe mbajnë vende të përshtatshme pune dhe të gjenerojnë të ardhura më të larta dhe volum të shtuar eksporti, veçanërisht në sektorët me intensitet të lartë pune, ku Shqipëria tregon potencial rritës, si bujqësia, TIK dhe turizmi.

Së fundmi, Zvicra do të përforcojë përqendrimin në AFP. Më shumë të rinj dhe të reja, veçanërisht nga grupet e cënueshme (romët, egjiptianët, jetimët dhe të miturit në konflikt me ligjin) duhet të gjejnë punësim falë një sistemi AFP të fuqizuar dhe të orientuar nga tregu i punës, që zbaton elementet e sistemit të dyfishtë zviceran, si dhe mbështet skemat e tranzicionit nga shkolla në punë (rezultati 3). Zvicra do të kontribuojë për uljen e numrit të personave që nuk janë në arsim, formim apo punë.

Objektivi i fushës së zhvillimit ekonomik dhe punësimit:

Rritja e qëndrueshme siguron më shumë punësim dhe mundësi më të mira biznesi për të gjithë.

Rezultatet e portofolit zviceran:

- Rezultati 1 – Stabiliteti makroekonomik: Institucionet kombëtare përmirësojnë menaxhimin e financave publike dhe mobilizimin e burimeve; sektori financiar fuqizohet.
- Rezultati 2 – Zhvillimi i sektorit privat: Përmirësohen kushtet për bërjen e biznesit, konkurrueshmëria e sektorit privat dhe sistemet e tregut.
- Rezultati 3 – Punësueshmëria: Të rinjtë përfitojnë nga arsimi dhe formimi profesional i orientuar nga tregu i punës si dhe nga vendosja më e mirë në vende pune.

Infrastruktura urbane dhe energjia: Hipoteza e impaktit të fushës së infrastrukturës urbane dhe energjisë është se qeverisja e përmirësuar e këtij sektori dhe mbikëqyrja më e mirë nga rregullatorët, menaxhimi më i fuqizuar i ndërmarrjeve publike dhe investimet në infrastrukturë do të çojnë në ofrim më të mirë të shërbimeve bashkiake. Fusha e *infrastrukturës urbane dhe energjisë* do të financohet nga SECO.

Zvicra do të vijojë të kontribuojë për akses të barasvlershëm në shërbime cilësore të infrastrukturës urbane dhe energjisë. Mbështetja për infrastrukturën do të përmirësojë ujin e pijshëm, shërbimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta në bashkitë e përzgjedhura për sa i përket besueshmërisë,

përbalueshmërisë, mbulimit të popullsisë, cilësisë së shërbimit dhe rezistencës ndaj kushteve klimatike. Përmirësimi i menaxhimit të ndërmarrjeve publike përgjegjëse do të plotësojë investimet financiare dhe do të rrisë qëndrueshmërinë e këtyre investimeve (rezultati 1). Masat për uljen e rrezikut nga katastrofat (DRR) do të mbështeten në zonat që janë të cënueshme nga ndikimi i ndryshimeve klimatike.

Zvicra do të fuqizojë më tej sektorin e energjisë dhe furnizimin e besueshëm të energjisë së diversifikuar, kryesisht përmes dialogut për politikën dhe ngritjes së kapaciteteve. Si një linjë e re ndërhyrjeje, Zvicra do të testojë mbështetjen për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në bashki të përzgjedhura (rezultati 2), duke kontribuar kështu për lehtësimin e ndryshimeve klimatike. Për të përqendruar më mirë portofolin do të përmbillen ndërhyrjet për sigurinë e digave.

Objektivi i fushës së infrastrukturës urbane dhe energjisë:

Popullata përfiton nga shërbimet e infrastrukturës bashkiake me cilësi të lartë dhe nga përmirësimi në furnizimin me energji dhe i efikasitetit të energjisë.

Rezultatet e portofolit zviceran:

- Rezultati 1 – Infrastruktura urbane: Popullata përfiton nga shërbime të besueshme, të përbalueshme dhe me cilësi të lartë të ujit të pijshëm, ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta, që ofrohen nga ndërmarrje publike të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme.
- Rezultati 2 – Në bashki të përzgjedhura, energjia furnizohet në mënyrë të besueshme dhe nga burime të ndryshme, si edhe përdoret me efikasitet.

Shëndetësia: Hipoteza e impaktit të fushës së shëndetësisë është se mbështetja e autoriteteve shëndetësore kombëtare dhe vendore, dhe e kapaciteteve të burimeve njerëzore për shëndetësinë dhe menaxhimin në shëndetësi, sjellin shërbime më të mira, cilësore dhe me efikasitet më të lartë në kujdesin shëndetësor parësor. Falë kujdesit të përmirësuar shëndetësor parësor, promovimit të shëndetit dhe nismave për parandalimin e sëmundjeve, popullata bën një jetë më të shëndetshme dhe përmirëson gjendjen shëndetësore. Fusha e *shëndetësisë* do të jetë përgjegjësi e SDC-së. Përkushtimi i vendit ndaj sektorit të shëndetësisë do të jetë aspekti kryesor për zhvillimin e këtij sektori.⁷

Në mbështetje të ZKSHI-së dhe Strategjisë Kombëtare të Shqipërisë për Shëndetësinë, Zvicra do të synojë për institucione më efikase të KSHP-së, që ofrojnë shërbime më të mira cilësore (rezultati 1).

7. Shih Kuadrin e Rezultaveve, Fusha Tematike 4, Shëndetësia, fusha 6 (f.40)

Për këtë qëllim, së pari Zvicra do të përqendrohet në aspektet e reformës në sistemin e shëndetësisë dhe që sjellin cilësi dhe efikasitet të përmirësuar. Ajo do të angazhohet në dialogun e politikave në mbështetje të reformave strukturore në kujdesin shëndetësor parësor.

Nga ana tjetër, Zvicra do të fuqizojë promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve, duke u përqendruar tek sëmundjet jo-ngjitëse që zënë pjesën më të madhe të sëmundjeve në Shqipëri. Angazhimi me partnerët, përfshirë OJF-të, do të rrisë njohuritë e popullatës mbi shëndetin si dhe kërkesat për kujdes cilësor (rezultati 2).

Objektivi i fushës së shëndetësisë:

Një popullsi e mirë-informuar dhe angazhuar në shëndetësi përfiton nga shërbimet e mirë ofruara dhe cilësore të kujdesit shëndetësor parësor

Rezultatet e portofolit zviceran:

- Rezultati 1 – Shërbimet shëndetësore: Institucione më efikase të kujdesit shëndetësor parësor ofrojnë shërbime cilësore më të mira.
- Rezultati 2 – Ndërgjegjësimi mbi shëndetin: Popullsia ka më shumë njohuri për shëndetin dhe institucionet e shëndetit publik orientohen drejt promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve, duke u përqendruar te sëmundjet jo-ngjitëse

Tema tej-përshkuese: Zvicra do integrojë në të gjitha fushat konceptin e qeverisjes së mirë dhe të ndjeshmërisë gjinore, në përputhje me udhëzimet e SDC-së dhe SECO-s. Për sa i përket integritetit të qeverisjes së mirë, Zvicra do të trajtojë korrupsionin dhe do të promovojë masat anti-korrupsion, si për shembull, në kuadrin e AFP-së, reformave në sektorin e shëndetësisë dhe zhvillimin korporativ të ndërmarrjeve publike. Ajo do të ndjekë aspekte të ndryshme të përfshirjes (shoqërore, ekonomike dhe politike) përmes një qasjeje programore.

Në të gjithë portofolin zviceran, projektet synojnë politikëbërjen me ndjeshmëri gjinore dhe rritjen e përfaqësimit të grave në proceset vendimmarrëse⁸, si dhe uljen e barrës së punës së papaguar për gratë dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në arsim dhe në tregun formal të punës.

Aty ku është e përshtatshme, Zvicra do të marrë në konsideratë aktivitete që adresojnë të shkuarën komuniste të Shqipërisë.

Shkaqet rrënjësore të migrimit do të trajtohen në të katërta fushat, duke qenë se papunësia, mungesa e arsimit cilësor dhe shërbimet shëndetësore janë faktorët shtytës kryesorë. Migrimi dhe zhvillimi do të trajtohen, kur është e nevojshme. Në veçanti, projektet do të kërkojnë mundësi për të përfituar nga diaspora (p.sh. si mentorë ose investitorë në biznese vendore, start-up, apo bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën të krijuar rishtazi), remitancat (p.sh. duke përdorur fondet për zhvillim dhe duke ulur tarifën për remitancat) dhe personat e kthyer (p.sh. duke përdorur njohuritë e tyre në sektorin e shëndetësisë).

Kultura dhe zhvillimi: Përveç katër fushave të ndërhyrjes, Ambasada e Zvicrës do të nxisë skenën e pavarur kulturore në Shqipëri dhe bashkëpunimin rajonal me palët e interesit të kulturës në Ballkanin Perëndimor. Një për qind e buxhetit operativ të SDC-së i kushtohet mbështetjes së nismave në sektorin e artit dhe kulturës vendase, përmes projekteve të përkushtuara dhe/ose programeve të bazuara në politikën për kulturën dhe zhvillimin të SDC-së.



Këngëtarja shqiptaro - zvicerane Elina Duni në koncert në Tiranë.

8. Ky është një 'detyrim' për të gjitha veprimtaritë e SDC-së; për ato të SECO-s, kur është e nevojshme.

6. Menaxhimi dhe zbatimi i programit

Përdorimi i sistemeve të vendit: Bazuar në parimet për një bashkëpunim efikas për zhvillim, synimi përfundimtar i Zvicrës është që të punohet përmes sistemeve të vendit. Zvicra në bashkëpunim të ngushtë me agjenci të tjera donatore, do të japë kontribut aktiv për të krijuar kushtet e nevojshme për zbatim dhe përdorim më të madh të sistemeve të Shqipërisë nga ana e institucioneve vendore, p.sh. duke fuqizuar MFP në nivel vendor dhe duke përmirësuar disponueshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave. Përshtatshmëria e përdorimit të sistemeve të vendit do të vlerësohet rregullisht nga afër.

Partneritetet: Organizatat shumëpalëshe, agjenci të tjera donatore, si dhe OJF-të zvicerane, ndërkombëtare dhe shqiptare do të mbeten partnerë të rëndësishëm. Në veçanti, Zvicra do të ndjekë në mënyrë aktive dialogun e politikave me shumë palë interesi, bashkërendimin me partnerët për zhvillim dhe do të kapë mundësitë për bashkëfinancim në mbështetje të qeverisë shqiptare dhe reformave të saj. Veçanërisht Zvicra synon të vijojë bashkërendimin e dy grupeve nëntematike për bashkërendimin e donatorëve për AFP-në dhe qeverisjen vendore.

Zvicra bashkëpunon ngushtësisht me organizatat shumëpalëshe të tilla si OKB (veçanërisht UNDP, UNICEF, OBSH, UNFPA dhe UN Women), Institucionet e Bretton Woods, BERZH, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) dhe Këshillin e Europës (KE). Më shumë bashkëpunim do të kërkohet me BE-në si një donator i ngjashëm. Në përputhje me Njoftimin Federal 2017-2020, do të identifikohen mundësitë për të punuar gjithnjë e më shumë me sektorin privat për bashkëpunimin zhvillimor me qëllim realizimin e rezultateve të zhvillimit.

Sinergjitë: Sinergjitë programatike, ose të paktën plotësimet dhe shtesat, mund të arrihen nga perspektiva të ndryshme. Një përpjekje e vetëdijshme do të bëhet për të identifikuar mundësitë për bashkëpunimin ndërsektorial dhe krijimin e sinergjive ndërmjet katër fushave të ndërhyrjes - p.sh. ndërmjet mbështetjes së MFP-së në nivel vendor dhe projekteve të infrastrukturës; ndërmjet qeverisjes vendore dhe shëndetit; ndërmjet mbikëqyrjes makroekonomike dhe mbështetjes për parlamentin, si dhe ndërmjet AFP-së dhe shëndetit. Fokusi më i madh në nivel kombëtar (në krahasim me fokusin e mëparshëm në rajonet e varfra të përzgjedhura) rrit hapësirën për të punuar në fusha ndërveprimi. Puna në këto fusha gjithashtu do të përfitojë nga sinergjitë me nismat rajonale dhe globale, përfshirë edhe programet e SDC-së në shëndetësi dhe angazhimet shumëpalëshe të SECO-s dhe SDC-së.

Anti-korrupsioni: Disa projekte do të kontribuojnë në uljen e korrupsionit (p.sh. mbështetja për Parlamentin dhe menaxhimi i financave publike) dhe në projekte do të përfshihen masa specifike anti-korrupsion (p.sh. në sektorin e shëndetësisë dhe ujit). Së fundi, personeli i Ambasadës dhe partnerët do të trajnohen dhe sensibilizohen për këtë temë.

Burimet: Angazhimet totale të planifikuara për 2018-2021 janë 105 milionë CHF. Qeverisja demokratike është fusha më e madhe në terma monetare (38 milionë CHF); shëndetësia është më e vogla (12 milionë CHF). Krahasuar me Strategjinë e bashkëpunimit zviceran 2014-2017, do të rriten financimi për *qeverisjen demokratike* (+46%), për *zhvillimin ekonomik dhe punësimin* (+41%), për shëndetësinë (+20%), ndërkohë që do të ketë një ulje të lehtë të fondeve për *infrastrukturën urbane dhe energjinë* (-8%). Rritja e financimit të SDC-së për AFP-në është në përputhje me Njoftimin Federal mbi Bashkëpunimin Ndërkombëtar. Shtojca 4 jep informacion të detajuar për periudhën 2018-2021 krahasuar me periudhën 2014-2017.⁹



Diskutime dhe punë në grup gjatë një seminari.

9. Shqipëria përfiton gjithashtu nga nisma rajonale dhe globale të financuara nga SDC dhe SECO. Kur fondet e tyre nuk janë të dedikuara për vende specifike, ato përfshihen në fondet e parashikuara për Strategjinë.

7. Drejtimi Strategjik

Qëllimi i sistemit të monitorimit të strategjisë së bashkëpunimit zviceran është të sigurojë informacion të rëndësishëm por të përzgjedhur në mënyrë të rregullt dhe në kohën e duhur, për të drejtuar zbatimin e strategjisë, në mënyrë që të arrihen objektivat e saj. Natyra dhe cilësia e informacioneve të mbledhura nëpërmjet monitorimit duhet të jetë në përputhje me këtë përgjegjësi. Sistemi i monitorimit ofron një tablo të përgjithshme e të besueshme, nga një 'pamje nga lart' e realitetit të programit, duke mbajtur një distancë kritike nga problemet dhe sprovat e zbatimit të projekteve. Sistemi i monitorimit synon të kontrollojë progresin dhe mangësitë e programit në tërësi nga pikëpamja përfundimtare e shënjestrave dhe arritjes së qëllimit, të matura këto me rezultatet, efektet dhe impaktin (qoftë ose jo të synuara). Kjo qasje do të ndihmojë procesin e drejtimit të programit duke siguruar edhe një bazë për të adaptuar portofolin zviceran, nëse kjo bëhet e nevojshme.

Përgjegjësia e përgjithshme për monitorimin dhe drejtimin e zbatimit të strategjisë së bashkëpunimit i takon Ambasadës së Zvicrës në Tiranë. Drejtimi strategjik i kësaj strategjie kryhet në tre nivele (kontekst, program, dhe monitorim i menaxhimit), dhe në dialog të vazhdueshëm me agjencitë zbatuese. Raportimi bëhet përmes raporteve vjetore (shih Shtojcën 5).

Monitorimi i kontekstit

Sistemi i monitorimit ofron një pasqyrë sesi strategjia e bashkëpunimit i përmbahet kontekstit duke përdorur analizën e zhvillimeve të vendit që kanë lidhje me strategjinë. Për këtë qëllim përdoret Sistemi i Monitorimit për Ndryshimet e Lidhura me Zhvillimin (MERV). Tabela e skenareve (shih Shtojcën 2) përmban përshtatje të strategjisë së bashkëpunimit të cilat mund të jenë të nevojshme në rast ndryshimesh në kontekst. Një fokus i veçantë do të vihet në vëzhgimin e sfidave të ndryshme të vendit (p.sh. korrupsioni dhe krimi i organizuar, siç është theksuar edhe në kapitullin 1) dhe ndikimet e tyre të mundshme në portofolin e vendit. Për këtë qëllim, Ambasada e Zvicrës do të mbajë gjithashtu një komunikim të rregullt me ambasadat edhe agjencitë e tjera donatore.

Monitorimi i programit

Sistemi i monitorimit të strategjisë së bashkëpunimit është i organizuar në mënyrë që efektiviteti dhe koherenca e zbatimit të tij, përfshi përdorimin e sistemeve të vendit, të kontrollohet në nivel programi nëpërmjet përdorimit të një matrice monitorimi që del nga Kuadri i Rezultateve (shih Shtojcën 3). Ky sistem vlerëson çdo vit progresin në drejtim të arritjes së rezultateve të pritshme të aktiviteteve zvicerane dhe kontributin e tyre në zhvillimin e vendit, duke përfshirë ato në lidhje me përfshirjen sociale, politike dhe ekonomike dhe temat tej-përshkuese siç janë gjinia dhe qeverisja.

Monitorimi i menaxhimit

Efikasiteti matet duke monitoruar shënjestrat e përgjithshme operationale të Ambasadës së Zvicrës. Këto shënjestra pasqyrojnë përdorimin më të mirë të burimeve njerëzore dhe financiare në arritjen e objektivave të projekteve dhe programeve të zbatuara me mbështetjen e Zvicrës. Për këtë qëllim, janë hartuar dhe rishikohen çdo vit planet operationale me objektivat dhe treguesit përkatës.

Sistemi i monitorimit është zhvilluar në mënyrë të tillë që ofron mundësi për të vlerësuar dobinë e të gjithë instrumenteve të monitorimit; duke u bazuar në gjetjet, ato mund të ndryshohen për të siguruar monitorim më të saktë dhe më praktik.

Shtojca 1: Përmbledhje e rezultateve 2018-2021 (Portofoli zviceran)

Qëllimi i Përgjithshëm i Strategjisë së Bashkëpunimit me Shqipërinë 2018-2021:

Kontribut për një demokraci funksionale, shërbime të përmirësuara publike dhe një ekonomi tregu konkurruese dhe përfshirëse në mbështetje të integritimit evropian të Shqipërisë

Qeverisja Demokratike	Zhvillimi Ekonomik dhe Punësimi	Infrastruktura Urbane dhe Energjia	Shëndetësia
<p><i>Objektivi:</i> Popullsia përfiton nga institucione përfshirëse, efikase dhe demokratike.</p>	<p><i>Objektivi:</i> Rritja e qëndrueshme siguron më shumë punësim dhe mundësi më të mira biznesi për të gjithë.</p>	<p><i>Objektivi:</i> Popullsia përfiton nga shërbimet e infrastrukturës bashkiake me cilësi të lartë dhe nga përmirësimi i furnizimit me energji dhe efikasitet të energjisë.</p>	<p><i>Objektivi:</i> Një popullsi e mirë-informuar dhe e angazhuar në shëndetësi përfiton nga shërbimet e mirëofruara dhe cilësore të kujdesit shëndetësor parësor.</p>
<p><u>Rezultati 1</u> (institucione ekzekutive me performancë të lartë): Institucione ekzekutive vendore të përgjegjshme që ofrojnë shërbime përfshirëse dhe efikase.</p>	<p><u>Rezultati 1</u> (stabiliteti makroekonomik): Institucionet kombëtare përmirësojnë menaxhimin e financave publike dhe mobilizimin e burimeve; sektori financiar forcohet.</p>	<p><u>Rezultati 1</u> (infrastruktura urbane): Popullsia përfiton nga shërbime me cilësi të lartë, të besueshme dhe të përbalueshme të ujit të pijshëm, ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta, që ofrohen nga ndërmarrje publike të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme.</p>	<p><u>Rezultati 1</u> (shërbimet shëndetësore): Më shumë institucione efikase të kujdesit shëndetësor parësor ofrojnë shërbime më të mira cilësore.</p>
<p><u>Rezultati 2</u> (organet legjislative): Kuvendi i Shqipërisë dhe këshillat bashkiake i kryejnë më mirë funksionet mbikëqyrëse dhe përfaqësuese.</p>	<p><u>Rezultati 2</u> (zhvillimi i sektorit privat): Kushtet kuadër për të bërë biznes, konkurrueshmëria në sektorin privat dhe sistemet e tregut përmirësohen.</p>	<p><u>Rezultati 2</u> (furnizimi me energji dhe efikasitet të energjisë): Në bashki të përzgjedhura, energjia furnizohet në mënyrë të besueshme dhe nga burime të ndryshme, si dhe përdoret me efikasitet.</p>	<p><u>Rezultati 2</u> (njohuritë për shëndetin): Popullsia ka më shumë njohuri për shëndetin dhe institucionet e shëndetit publik orientohen drejt promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve, duke u përqendruar te sëmundjet jo-ngjitëse.</p>
<p><u>Rezultati 3</u> (angazhimi qytetar): Qytetarët dhe shoqëria civile angazhohen në vendimmarrje dhe i kërkojnë llogari qeverisë.</p>	<p><u>Rezultati 3</u> (punësueshmëria): Të rinjtë përfitojnë nga arsimit dhe formimi profesional i orientuar nga tregu i punës dhe nga vendosja më e mirë në vende pune.</p>		

Tema tej-përshkuese: Gjinia, Qeverisja

Shtojca 2: Skenarët e kontekstit

Skenari pesimist: Reformat ndalojnë	Skenari realist: Progres gradual në reforma	Skenari optimist: Integrim i përshpejtuar në BE
Politika / Qeverisja		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Negociatat me BE-në ngecin në vend nëse dështojnë procesi i vetingut dhe reforma në drejtësi. Korrupsioni është i përhapur kudo. ▪ Opozita bojkoton parlamentin. Qeveria vepron gjithnjë e më shumë në mënyrë autoritare dhe rrit klientelizmin. Media kontrollohet gjithnjë e më shumë nga elita e biznesit dhe politikës. ▪ Krimi i organizuar rritet, duke minuar gjithnjë e më shumë demokracinë. ▪ Shoqëria civile pasqyron politikën partiake, duke minuar kështu besueshmërinë e saj. ▪ Qeverisja vendore nuk ka fonde dhe kompetenca për ofrimin e shërbimeve. Qeveria e Shqipërisë (QSH) centralizohet edhe më tej. Reforma territoriale shihet si dështim. Femrat janë më pak të pranishme në politikë në nivel vendor dhe qendror. ▪ Marrëdhëniet me Serbinë, Maqedoninë dhe Greqinë përkeqësohen, duke rrezikuar stabilitetin rajonal. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ BE-ja hap negociatat, por me progres të ngadalshëm. Elita politike shqiptare frenon reformën në drejtësi. Korrupsioni mbetet problem. ▪ Polarizimi dhe klientelizmi dominojnë kulturën politike. Korrupsioni zgjedhor pengon krijimin e institucioneve transparente dhe demokratike. Media është kapur nga interesat politike dhe ekonomike. ▪ Qeveria e Shqipërisë lufton kultivimin e kanabisit, e megjithatë përzjerja e politikanëve dhe policisë me krimin e organizuar është vështirë të trajtohet. ▪ Shoqëria civile rrit ngadalë aktivizimin e saj, duke kërkuar më shumë transparencë dhe llogaridhënie nga institucionet shtetërore. ▪ Qeverisja vendore fillon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve, por jo në zonat e largëta. Lufta e pushtetit mbi decentralizimin vazhdon. Përqindja e femrave përmirësohet në strukturat e pushtetit në të gjitha nivelet. ▪ Shqipëria angazhohet në nismat rajonale dhe ka marrëdhënie të qëndrueshme me vendet fqinje. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Negociatat me BE-në hapen dhe përparojnë. Reforma në drejtësi po zbatohet dhe tregon rezultate konkrete përmes vetingut. ▪ Partitë politike debatojnë në mënyrë konstruktive. Reforma zgjedhore garanton zgjedhje të lira dhe të ndershme. Performanca konsiderohet gjithnjë e më shumë si kriter për rekrutimin në administratën publike. Media e pavarur përmirëson transparencën. ▪ Qeveria e Shqipërisë trajton shkaqet thelbësore të kultivimit të kanabisit. Një pushtet gjyqësor dhe një polici më funksionale luftojnë krimin e organizuar. ▪ Shoqëria civile bëhet më e pavarur dhe më e fortë, duke kërkuar më shumë llogaridhënie nga institucionet shtetërore. ▪ Qeverisja vendore ofron shërbime përfshirëse. Decentralizimi përparon. Shqipëria bëhet një histori suksesi në aspektin e përfaqësimit të femrave në qeveri. ▪ Shqipëria angazhohet në mënyrë konstruktive në nismat rajonale dhe luan një rol arbitri në rajon.
Economia		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngadalësimi i rritjes ekonomike rrit papunësinë dhe pabarazitë. ▪ Reformat kryesore të ndërmarra (konsolidimi fiskal, menaxhimi i shpenzimeve publike, reforma rregullatore, AFP) ngadalësohen në mënyrë të konsiderueshme. ▪ Investimet dekurajohen për shkak të paqëndrueshmërisë politike, qeverisjes së keqe dhe çështjeve të pazgjdhura të pronësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritja e moderuar ekonomike prej 3-4% ofron përfitime të kufizuara në aspektin e vendeve të punës dhe të ardhurave. ▪ Qeveria angazhohet për axhendën makroekonomike dhe stabilitetin fiskal. Borxhi publik ulet, inflacioni është i qëndrueshëm, cilësia e AFP-së përmirësohet me ngadalësi. ▪ Sektori privat përballet me sfida që lidhen me sistemin tatimor, çështje të pronësisë dhe zbatimin e ligjit. Investimet janë të kufizuara. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritja ekonomike sjell më shumë vende pune, investime dhe shpërndarje më të mirë të pasurisë. ▪ Reformat në makroekonomi dhe stabilitetin fiskal janë të suksesshme. Borxhi është ulur dhe inflacioni është i kontrolluar. ▪ Qeveria e Shqipërisë krijon një klimë më të mirë investimesh, tërheq më shumë investime të huaja dhe nxit AFP-në.
Aspekti Social/Shëndetësia		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Normat e varfërisë dhe numri i njerëzve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, rritet. Dështon ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe atij social në nivel vendor. Përrjashtimi dhe pabarazitë gjinore bëhen më të dukshme. ▪ Emigracioni rritet ndjeshëm. Shqipëria bëhet rrugë për refugjatët. ▪ Ekstremizmi fetar rritet. Veprimet mbi barazinë gjinore bëhen të vështira për t'u zbatuar. ▪ Nuk ka angazhim për reformë në sektorin e shëndetësisë. Qytetarët marrin shërbime shëndetësore me cilësi të keqe. Korrupsioni vazhdon. ▪ Për shkak të mungesës së burimeve financiare, Qeveria e Shqipërisë i drejtohet gjithnjë e më shumë privatizimit. Shumica e buxhetit të shtetit shkon për spitalet, duke ulur më tej nivelin parësor. Qytetarët anashkalojnë kujdesin parësor dhe paguajnë më shumë nën dorë (OOP). ▪ Një numër më i madh specialistësh të shëndetit dhe infermierë largohen nga vendi. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Normat e varfërisë ulen pak; pabarazitë midis zonave urbane dhe rurale zvogëlohen, por mbeten midis kryeqytetit dhe pjesës tjetër. Ofrimi i shërbimit të decentralizuar të shëndetit publik dhe kujdesit social përparon, por grupet e cënueshme nuk gëzojnë akses të barabartë. Masat e barazisë gjinore zbatohen kryesisht në zonat urbane. ▪ Prirja për emigrim dhe largimi i trurit vazhdon. ▪ Toleranca fetare vazhdon, por nuk parandalohet ekstremizmi fetar. ▪ Zbatimi i strategjisë kombëtare shëndetësore është sfidues dhe kërkon kohë. Bashkitë marrin përgjegjësi shtesë (financiare) për sektorin e shëndetësisë. Llogaridhënia përmirësohet pak, por mbetet problem. ▪ Financimi nga QSH-ja për sektorin e shëndetësisë arrin afërsisht në 4% dhe privatizohen më shumë shërbime dhe funksione shëndetësore. Qytetarët zvogëlojnë pak pagesat nën dorë (OOP). ▪ Pjesa më e specializuar e fuqisë punëtore shëndetësore e sheh migracionin jashtë Shqipërisë si një mundësi më të mirë për karrierën. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Normat e varfërisë ulen në mënyrë të konsiderueshme; pabarazitë midis zonave urbane dhe rurale/kryeqytetit dhe pjesës tjetër zvogëlohen. Shërbimet publike të kujdesit social decentralizohen. Sigurohet akses i barabartë në mundësi. Masat e barazisë gjinore prodhojnë rezultate të rëndësishme. ▪ Emigrojnë më pak njerëz. ▪ Toleranca fetare vazhdon. Autoritetet shtetërore punojnë tërësisht për parandalimin e ekstremizmit fetar. ▪ Qeveria e Shqipërisë nis dhe zbaton një reformë në shëndetësi që përqendrohet në kujdesin shëndetësor parësor dhe kujdesin parandalues. Shëndetësia bëhet më e decentralizuar. Llogaridhënia përmirësohet. ▪ Financimi për sektorin e shëndetësisë shkon mbi 5% të PBB-së dhe prezantohet dhe zbatohet një sistem i ri dhe efektiv i financimit shëndetësor. Pagesat nën dorë reduktohen. ▪ Kushte më të mira të punës mbajnë fuqinë punëtore shëndetësore në vend.

Uji & Mjedisi

<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësia, disponueshmëria dhe qëndrueshmëria e shërbimeve të ujit dhe mbetjeve përkeqësohet. ▪ Fatkeqësitë natyrore ndikojnë negativisht në furnizimin me energji dhe gjendjen socio-ekonomike. ▪ Fatkeqësitë natyrore e godasin Shqipërinë në një masë të madhe, duke krijuar dëme njerëzore, financiare dhe pasurore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Arrihet progres i kufizuar në përmirësimin e cilësisë, në besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta mbetet problematik. ▪ Furnizimi me energji mbetet i cënueshëm. ▪ Ndërmerret një punë e kufizuar për parandalimin dhe gadishmërinë në lidhje me fatkeqësitë natyrore. Fatkeqësitë eventuale natyrore ndikojnë negativisht në furnizimin me energji dhe në prona. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësia, mbulimi, dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve publike në menaxhimin e ujit dhe mbetjeve përmirësohen. ▪ Besueshmëria e furnizimit me energji përmirësohet dhe diversifikimi i burimeve të energjisë përparon. ▪ Qeveria e Shqipërisë punon për parandalimin e rreziqeve të fatkeqësive.
--	--	--

Implikimet e skenarëve për fushat e punës

Skenari pesimist: Reformat ndalojnë	Skenari realist: Progres gradual në reforma	Skenari optimist: Integrim i përshpejtuar në BE
Democratic governance		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të punohet me aktorët e ndryshimit në nivel teknik nëpër bashki. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 1: Institucionet ekzekutive me performancë të lartë ▪ Institucione ekzekutive vendore të përgjegjshme ofrojnë shërbime përfshirëse dhe efikase. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të forcohen institucionet në nivel nën-kombëtar. ▪ Të punohet më shumë në sistemin përmes agjencive kombëtare për forcimin e Njësisë të Qeverisjes Vendore (NjQV). ▪ T'i jepet mbështetja me grante NjQV-ve duke marrë parasysh performancën e tyre.
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të mbështetet ana administrative e legjislativit dhe të bazuarit mbi të dhëna. Të punohet për çështjet në komisione dhe aleanca që mbështesin ndërtimin e konsensusit në vend të bojkotit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 2: Organet legjislative ▪ Kuvendi i Shqipërisë dhe këshillat bashkiake i kryejnë më mirë funksionet mbikëqyrëse dhe përfaqësuese. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të forcohen kapacitetet institucionale të parlamentit. ▪ Të forcohet roli institucional i këshillave bashkiake
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të intensifikohet puna me pjesën e besueshme të shoqërisë civile. ▪ Të konsiderohet mbështetja për median dhe aktorë të tjerë të mundshëm të ndryshimit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 3: Angazhimi qytetar ▪ Qytetarët dhe shoqëria civile angazhohen në vendimmarrje dhe i kërkojnë llogari qeverisë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nuk nevojiten ndryshime.
Zhvillimi ekonomik dhe punësimi		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përdoren mundësi në fushat ku reformat janë ende të realizueshme. ▪ Të rritet dialogu i politikave për nxitjen e ndryshimeve. ▪ Të punohet më shumë me aktorë të sektorit privat duke rritur aftësitë e tyre dhe sipërmarrjen. ▪ Të rishqyrtohet mbështetja për qeverisjen korporative. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 1: Stabiliteti makro-ekonomik ▪ Institucionet kombëtare përmirësojnë menaxhimin e financave publike dhe mobilizimin e burimeve; sektori financiar forcohet. ▪ Rezultati 2: Zhvillimi i sektorit privat ▪ Kushtet kuadër për të bërë biznes, konkurrueshmëria e sektorit privat dhe sistemet e tregut përmirësohen. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nuk nevojiten ndryshime.
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të zhvendoset mbështetja për AFP-në tek aktorët e sektorit privat. ▪ Të fokusohet më shumë në masat aktive të tregut të punës në mënyrë që të angazhohen të rinjtë në tregun e punës. ▪ Të rritet dialogu i politikave për të nxitur vazhdimësinë e axhendës së reformës për AFP-në. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 3: Punësueshmëria ▪ Të rinjtë përfitojnë nga arsimit dhe formimi profesional i orientuar nga tregu i punës dhe nga vendosja më e mirë në vende pune. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të zgjerohet mbështetja për reformat e AFP-së dhe shkollat.
Infrastruktura Urbane dhe Energjia		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të rritet mbështetja për bashkitë që aplikojnë qeverisjen e mirë. ▪ Të rritet pjesëmarrja e palëve të interesuara për të ushtruar presion mbi autoritetet përkatëse. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 1: Infrastruktura Urbane ▪ Popullsia përfiton nga shërbime të besueshme, të përbalueshme dhe me cilësi të lartë të ujit të pijshëm, ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta që ofrohen nga ndërmarrje publike të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Më shumë bashkë-financim nga partnerët kombëtarë. ▪ Të mbështeten reformat në nivel kombëtar dhe zbatimi i tyre.
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kalimi i mbështetjes nga qeverisja qendrore tek bashkitë që tregojnë gatishmëri për të përmirësuar efikasitetin e energjisë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 2: Furnizimi me energji dhe efikasiteti ▪ Në bashki të përzgjedhura, energjia furnizohet në mënyrë të besueshme dhe nga burime të ndryshme, si dhe përdoret me efikasitet 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vlerësohet zgjerimi i mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve në nivel kombëtar.
Shëndetësia		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të punohet në nivel teknik dhe vendor, duke u përqendruar në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit. ▪ Të vendosen kushte për vazhdimin e mëtejshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 1: Shërbimet shëndetësore ▪ Institucione më efikase të kujdesit shëndetësor parësor ofrojnë shërbime cilësore më të mira. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të pilotohen modele të reja të ofrimit të shërbimit. ▪ Të mbështetet ristrukturimi i KSHP. ▪ Të mbështeten burimet njerëzore në shëndetësi, me ndarje/zhvendosje të detyrave, kujdes të specializuar, etj.
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përfshihet dhe të mobilizohet më tej komuniteti për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultati 2: Njohuritë për shëndetin ▪ Popullsia ka më shumë njohuri për shëndetin dhe institucionet e shëndetit publik orientohen drejt promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve, duke u përqendruar te sëmundjet jo-ngjitëse. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të mbështeten organizatat e të drejtave të pacientëve dhe aktorë të tjerë joshëtitërorë që kërkojnë të drejtat e tyre (shoqata profesionistësh). ▪ Të punohet përmes praktikave më të mira për uljen e faktorëve të rrezikut të sëmundjeve jo-ngjitëse.

Shtojca 3: Kuadri i rezultateve

Fusha e ndërhyrjes 1: Qeverisja demokratike (SDC, SECO)		
Objektivi: Popullsia përfiton nga institucione përfshirëse, të efektshme dhe demokratike (kontribuon drejt SDG 16)		
Hipoteza e impaktit: Mbështetja e njëzive të qeverisjes vendore, pushtetit legjislativ në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe shoqërisë civile dhe grupeve të cënueshme të caktuara, sjell procese vendimmarrëse që janë më afër njerëzve dhe që përforcojnë pjesëmarrjen e tyre.		
(1) Rezultatet e portofolit zviceran	(2) Kontributi i Programit Zviceran	(3) Rezultatet e zhvillimit të vendit
Deklarata e rezultatit 1 Institucione ekzekutive me performancë të lartë: Institucione ekzekutive të përgjegjshme në nivel nën-kombëtar, që ofrojnë shërbime përfshirëse dhe efikase. Treguesit: 1) Menaxhimi i shëndoshë publik (SI 2 i SECO-s, modif.): Numri i bashkive të mbështetura (NJQV) me praktikën e administratës publike, në përputhje me standardet minimale të njohura ndërkombëtare. <i>Studimi bazë 2017:</i> Treguesit e përzgjedhur të PEFA-s: 0 NJQV, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore: 0 NJQV. <i>Shënjestra për 2021:</i> Përmirësimi i treguesve të përzgjedhur të PEFA-s: 61 NJQV, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore: 61 NJQV. 2) Efikasiteti në ndërveprimet ndërmjet autoriteteve qeveritare (vertikale dhe horizontale): Koordinim dhe bashkëpunim i përmirësuar i midis autoriteteve qeveritare dhe aktorëve përgjegjës të sektorit publik në nivele të ndryshme (DDLGI RI). <i>Studimi bazë 2018:</i> Ngritja e këshillit konsultativ. <i>Shënjestra për 2021:</i> Zhvillohen takime të rregullta të këshillit konsultativ; strukturat e zhvillimit rajonal funksionojnë në bazë të një kuadri ligjor; më shumë fonde të akorduara në nivel rajonal në bazë të programeve. 3) Ofrimi i shërbimeve publike të cilësisë së lartë (DDLGN RI 9 modif.): Raporti i popullsisë së mbuluar nga shërbimet është në përputhje me standardet minimale ndërkombëtare të njohura. <i>Studimi bazë 2018:</i> % e popullatës, duke përfshirë % e romëve të varfër dhe atyre me aftësi të kufizuara, mbulohen nga shërbimet e përzgjedhura ¹⁰ në përputhje me standardet minimale ndërkombëtare të njohura. <i>Shënjestra për 2021:</i> % e popullatës, duke përfshirë % e romëve të varfër dhe personave me aftësi të kufizuara, mbulohen nga shërbimet e zgjedhura në përputhje me standardet minimale ndërkombëtare të njohura.	Zvicra kontribuon për institucione publike funksionale transparente dhe më të mira përmes qeverisjes së përmirësuar bashkiake dhe zhvillimit rajonal. Kjo përfshin ofrimin e shërbimeve përfshirëse në nivel vendor, për shërbimet administrative dhe sociale. Programi gjithashtu përqendrohet në funksionimin më të mirë të administratave bashkiake, në kapacitete më të parashikueshme, të besueshme dhe transparente të MFP bashkiake, dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë nga ana e bashkive që informon dhe përfshin qytetarët. Regjistra statistikore bashkiakë do të ngrihen me mbështetje zvicerane dhe do të sigurohen statistika në nivel bashkiak. Zvicra mbështet koordinimin ndërmjet autoriteteve vendore dhe kombëtare për të lehtësuar këto reforma. Zvicra kontribuon në rritjen e transparencës dhe parashikueshmërisë në menaxhimin e burimeve publike, veçanërisht në lidhje me kuadrin ligjor dhe financiar si dhe përmes forcimit institucional. <i>Supozimet:</i> <ul style="list-style-type: none"> Vazhdon konsolidimi i Reformës Administrative Territoriale drejt një decentralizimi të plotë, duke përfshirë decentralizimin fiskal. Qeverisja qendrore është e angazhuar për të ndjekur hartimin dhe zbatimin e reformës për zhvillimin rajonal. <i>Rreziqet:</i> <ul style="list-style-type: none"> Angazhim i dobët dhe progres i ngadaltë në zbatimin e reformës së administratës publike në nivel qendror, vendor dhe ndërqeveritar. Ndryshimet e stafit për shkak të rotacionit politik rrezikojnë qëndrueshmërinë e projekteve. Nuk kërkohet bashkëpunimi ndër-bashkiak për shkak të përkatësive të ndryshme politike. Prirjet për centralizim kundërshtojnë qasjen nga poshtë-lart në zhvillimin dhe zbatimin e kuadrit për zhvillimin rajonal. 	Deklarata e rezultatit 1 Institucione publike transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e publikut, garantojnë shërbime cilësore, dhe që nuk bien pre e praktikave korruptive (SKZHI 2015-2020). Treguesit: 1) Treguesi i përbërë i Qeverisjes dhe Reformës në Administratën Publike: mesatarja e efektivitetit të qeverisjes, barra e rregullimit të qeverisjes dhe cilësia rregullatore. ¹¹ <i>Studimi bazë 2012:</i> 53.23 <i>Shënjestra 2020:</i> 63.19 2) Standardet e shërbimeve të përcaktuara dhe të zbatuara: <i>Studimi bazë 2014:</i> 1 Sektor (arsimi) <i>Shënjestra për 2020:</i> 100% e shërbimeve

10. Përzgjedhja e shërbimeve ka përfunduar, gjithë sesi në varësi të fushës së punës së Bashkivët forta. Një nga shërbimet e përzgjedhura do të jenë shërbimet sociale, dhe një tjetër do të përcaktohet në janar 2018, duke përfshirë studimin paraprak dhe vlerën e synuar

11. Shkalla midis 1 (vlerësimi më i keq) dhe 100 (vlerësimi më i mirë) e treguesit të përbërë; Burimi: SKZHI 2015-2020; Dokumenti Indikativ Strategjik i BE-së për Shqipërinë 2014-2020.

<p>Deklarata e rezultatit 2</p> <p>Organet legjislative: Kuvendi i Shqipërisë dhe këshillat bashkiake kryejnë më mirë funksionet e tyre mbikëqyrëse dhe përfaqësuese.</p> <p>Treguesit:</p> <p>1) Përfaqësimi nga Kuvendi (DDLGN RI 2): kënaqshmëria e popullsisë së interesat e saj përfaqësohen nga kuvendi dhe këshillat bashkiake (të ndarë sipas gjinisë).</p> <p><i>Studimi bazë</i>¹²: (nuk ka të dhëna) kënaqshmëria e popullsisë për Kuvendin e Shqipërisë, (nuk ka të dhëna) kënaqshmëria për këshillat bashkiake.¹³</p> <p><i>Shënjestra për 2021:</i> 50% kënaqshmëri për kuvendin e Shqipërisë dhe 50% për këshillat bashkiake.</p> <p>2) Roli mbikëqyrës i organeve legjislative: Kuvendi dhe këshillat bashkiake marrin masa për mbikëqyrjen e nivelit ekzekutiv në bazë të raporteve të komisionerëve dhe auditimeve, etj.</p> <p><i>Studimi bazë 2017:</i> 4 interpelanca parlamentare, 2 komisione hetimore, 9 seanca dëgjimore, 70 kërkesa për informacion.</p> <p><i>Shënjestra për 2021:</i> 10 interpelanca parlamentare, 5 komisione hetimore, 15 seanca dëgjimore, 100 kërkesa për informacion.</p>	<p>Zvicra kontribuon për një mbikëqyrje më të mirë të institucioneve ekzekutive duke forcuar parlamentin dhe këshillat bashkiake në funksionet e tyre kryesore.</p> <p>Do të përfordhet marrëdhënia e deputetëve të parlamentit dhe anëtarëve të këshillave bashkiake me qytetarët dhe do të mbështeten përpjekjet për reforma ligjore për të përmirësuar përfaqësimin e të gjithë popullsisë në degët legjislative.</p> <p><i>Supozimet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Kuvendi i Shqipërisë dhe këshillat bashkiake bëhen më të hapura dhe më transparente. <p><i>Rreziqet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Interesat partiake pengojnë parlamentin dhe këshillat bashkiake në funksionet e tyre kryesore, p.sh. përmes bojkotit. Mungesa e kapaciteteve teknike në shërbimet administrative të parlamentit vështirëson punën e deputetëve të parlamentit. Nuk ka ndarje midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. 	<p>Deklarata e rezultatit 2</p> <p>Proces legjislativ transparent, përfshirës dhe cilësor, në përputhje me praktikën më të mira europiane (SKZHI 2015-2020).</p> <p>Treguesit:</p> <p>1) Numri i nismave për politikën publike dhe për monitorimin dhe kontrollin financiar dhe administrativ nga këshillat bashkiake.¹⁴</p> <p><i>Studimi Bazë 2016:</i> ende nuk ka të dhëna; të dhënat nga matjet e para në 2016/7</p> <p><i>Shënjestra për 2020:</i> prirje në rritje</p>
<p>Deklarata e rezultatit 3</p> <p>Angazhimi qytetar: Qytetarët dhe shoqëria civile të angazhohen në vendimmarrje dhe t'i kërkojnë llogari qeverisë.</p> <p>Treguesit:</p> <p>1) Efektiviteti i nismave të shoqërisë civile (DDLGN RI 3): numri i kërkesave të bazuara dhe të bashkërenduara apo propozimet e mbështetura nga OSHC-të, mediat apo qytetarët ndaj organeve shtetërore. Midis këtyre, jepet numri i atyre që përfaqësojnë interesat e grave, grupeve të cënueshme të popullsisë dhe numri përkatës që rezultojnë në masa konkrete.</p> <p><i>Studimi bazë 2018:</i> do të hartohet.</p> <p><i>Shënjestra për 2021:</i> 4 nisma për gratë, 2 për grupet e cënueshme dhe 6 që rezultojnë në masa konkrete.</p> <p>2) Transparenca dhe hapja e qeverisjes vendore (ARI GO 01): numri i autoriteteve vendore që informojnë qytetarët në mënyrë transparente, që i përfshijn ata në proceset e vendimmarrjes dhe që merr parasysh interesat e tyre në zhvillimin vendor dhe rajonal dhe planet buxhetore, përfshirë masat specifike për grupet në nevojë.</p> <p><i>Studimi bazë 2018:</i> (duhet përcaktuar); bashkitë kryejnë konsultime sistematike me qytetarët, (duhet përcaktuar) nr. i NJQV-ve që vlerësohen më lart përsa i përket transparencës.</p> <p><i>Shënjestra për 2021:</i> Të gjitha 61 bashkitë përfshijnë qytetarët në vendimmarrje dhe marrin parasysh interesat e tyre. Të gjitha bashkitë përmirësojnë vlerësimin mbi transparencën.</p>	<p>Zvicra kontribuon në përmirësimin e demokracisë duke mbështetur aktorët civilë, përfshirë mediat, në aksionet e tyre lidhur me vendosjen e prioritetëve, vendimmarrjen dhe llogaridhënien e autoriteteve qeveritare.</p> <p><i>Supozimet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Është vendosur dhe po zbatohet kuadri rregullator për përmirësimin e situatës së shoqërisë civile. Shoqëria civile fillon të përqendrohet më shumë në fuqizimin e mbështetësve të saj. <p><i>Rreziqet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Prirja për politizimin e shoqërisë civile dhe mediave vazhdon. Apatia politike dhe frustrimi i përgjithshëm midis popullsisë pengon mobilizimin të qytetarëve. Rritje e kufizuar e lirisë së mediave. 	<p>Deklarata e rezultatit 3</p> <p>Bashkëpunim më i mirë dhe partneritet ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile, duke përfshirë ekzistencën e medias së lirë dhe të pavarur (SKZHI 2015-2020).</p> <p>Treguesit:</p> <p>1) Forcimi i strukturave të komunitetit në nivel vendor (kryetarët e fshatrave, lidhjet me qytetet): numri i 61 bashkive të reja që kanë struktura komunitare.</p> <p><i>Studimi bazë 2016:</i> 0%</p> <p><i>Shënjestra për 2020:</i> 50%</p> <p>2) Hartimi i një programi për mundësinë e qasjes efektive të qytetarëve në vendimmarrjen vendore dhe akteve normative vendore, nëpërmjet publikimit proaktiv dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.¹⁵</p> <p><i>Studimi bazë 2015:</i> 30%</p> <p><i>Shënjestra për 2020:</i> 100%</p>

12. IDM: Sondazhi Besimi në Qeveri, Shqipëri 2016.

13. Nuk ka të dhëna, Proxy:49% besojnë në qeverisjen vendore (IDM 2016).

14. Burimi: Strategjia Ndërsëktoriale Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020

15. Burimi: Strategjia Ndërsëktoriale Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020

(4) Linjat e aktivitetit (Programi zviceran)

Rezultati 1:

- Mbështetja për bashkitë e përzgjedhura në përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në fushat kryesore të MFP-së, bazuar në gjetjet e PEFA-s në nivel nën-kombëtar.
- Forcimi i bashkive në menaxhimin me efikasitet të shërbimeve sociale dhe promovimin e përfshirjes sociale, dhe forcimi i qeverisë qendrore në zbatimin e kuadrit të politikave, për sigurimin dhe financimin e shërbimeve sociale.
- Forcimi i bashkive në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve si dhe zhvillimit vendor dhe rajonal.
- Mbështetja për zhvillimin e statistikave vendore (bazuar në regjistër sipas funksionit).
- Rritja e përgjegjësisë dhe mbështetja e Qeverisë Shqiptare në zbatimin e reformës në administratën publike (Menaxhimin e Burimeve Njerëzore) në nivel vendor.
- Mbështetja në mënyrë aktive e qeverisë qendrore dhe strukturave rajonale, duke përfshirë pushtetin vendor dhe palët e interesuara në hartimin dhe zbatimin e reformës për zhvillimin rajonal.

Rezultati 2:

- Mbështetja për këshillat bashkiake dhe parlamentin në funksionet kryesore si përfaqësimi, ndoshta edhe funksionet legjislativ dhe mbikëqyrës. Kjo do të thotë se administrata parlamentare do të forcohet, si edhe anëtarët e parlamentit dhe këshilltarët do të përgatiten në temat e përzgjedhura. Fushat e ndërhyrjes do të përcaktohen në fillim të viti 2018.

Rezultati 3:

- Forcimi i demokracisë duke mbështetur faktorët nxitës të ndryshimit për të kërkuar përfshirje në procesin e vendimmarrjes, llogaridhënie dhe transparencë nga institucionet qeveritare.
- Mbështetja për fuqizimin e popullatës së cënueshme për të patur qasje të barabartë të mundësive dhe për të shprehur mendimin e tyre për vendime që ndikojnë në jetën e tyre.
- Nxitja e mobilizimit të qytetarëve nëpërmjet aktiviteteve të edukimit qytetar.
- Mbështetja e kapacitetit dhe e gatishmërisë së bashkive për të dhënë llogari ndaj qytetarëve të tyre dhe për t'i përfshirë ata në proceset vendimmarrëse.
- Forcimi i ndërlidhjes dhe bashkëpunimit ndërmjet ofertës dhe kërkesës nga ana e aktorëve të llogaridhënies.

(5) Burimet, partneritetet (Programi zviceran)

Buxheti: 38 milionë CHF (SDC 35 milionë CHF, SECO 3 milionë CHF për MFP në nivel nën-kombëtar)

Partnerët: Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencitë për Zhvillim Rajonal, Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, OSHC-të, media, këshillat bashkiake dhe administratat bashkiake (Njësitë e Qeverisjes Vendore), Shoqata e Bashkive dhe Shoqata e Qarqeve.

Koordinimi me partnerët e zhvillimit: USAID, BB, BE, SIDA, UNDP, OKB, OSBE, KiE

(6) Rezultatet e menaxhimit/performancës, duke përfshirë treguesit (Programi zviceran)

- Portofoli i qeverisjes pëson një ndryshim mjaft strategjik në përfshirjen e ndërhyrjeve të reja dhe mbylljen graduale të projekteve afatgjata. Për këtë arsye nevojitet një drejtim strategjik gjatë gjithë zbatimit të strategjisë për bashkëpunim, si dhe më shumë përqendrim te rezultatet. Treguesi: rregullim strategjik i portofolit sipas kuadrit të rezultateve të strategjisë për bashkëpunim.
- Zvicra mbetet e përkushtuar për të siguruar një rol udhëheqës në koordinimin tematik dhe kontribuon në mënyrë aktive për një koordinim të zgjeruar dhe sinergji midis të gjithë partnerëve. Sinergjitë e ndërhyrjeve zvicerane do të nxiten në nivel nën-kombëtar. Treguesi: # i kontributeve që rritin sinergjitë dhe që rezultojnë nga koordinimi i brendshëm dhe i jashtëm tematik.
- Do të kërkohet një dialog i ngushtë politikash me ministritë përkatëse dhe lidhje e mëtejshme për përmirësimin e çështjeve vendore dhe rajonale, si dhe Reforma e Administratës Publike. Treguesi: # i kontributeve të formuluar dhe të pranuar për përmirësimin e reformave.

Fusha e ndërhyrjes 2: Zhvillimi ekonomik dhe punësimi (SDC, SECO)		
Objektivi: Rritja e qëndrueshme siguron më shumë punësim dhe mundësi më të mira biznesi për të gjithë (kontribuon drejt SDG 8)		
Hipoteza e impaktit: Duke nxitur një stabilitet të qëndrueshëm makroekonomik dhe duke trajtuar sfida të ndryshme kyçe të sektorit privat, mundësohet rritja e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Zhvillimi i aftësive të duhura të popullsisë (të rinjve), të orientuara drejt tregut, rrit punësueshmërinë e tyre dhe në kështu ul papunësinë për të gjitha segmentet e shoqërisë.		
(1) Rezultatet e portofolit zviceran	(2) Kontributi i Programit Zviceran	(3) Rezultatet e zhvillimit të vendit
Deklarata e rezultatit 1 Stabiliteti makroekonomik: Institucionet kombëtare përmirësojnë menaxhimin e financave publike dhe mobilizimin e burimeve; sektori financiar forcohet. Treguesit: 1) Treguesit kyç të MFP-së, sipas kuadrit të PEFA-s (SECO SI 2). <i>Studimi bazë 2017:</i> sipas vlerësimit të PEFA 2017 (në vazhdim). <i>Shënjestra për 2021:</i> treguesit kyç të MFP-së të përmirësuar sipas PEFA-s. 2) Masat për përmirësimin e zhvillimit të kapaciteteve të MFP-së (SECO SI 3). <i>Studimi bazë 2017:</i> Kapacitete të pamjaftueshme të zyrtarëve për të ofruar shërbime transparente dhe të besueshme të MFP-së. <i>Shënjestra për 2021:</i> Kapacitete të mjaftueshme të zyrtarëve për të ofruar shërbime transparente dhe të besueshme të MFP-së. 3) Masat për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut financiar (SECO SI 5). <i>Studimi bazë 2017:</i> 3 Fonde investimesh vepronjë me vlerën neto të aseteve rreth 520 milionë euro; rregullatori financiar jobankar ka mjete të pamjaftueshme dhe kapacitete të ulëta për të mbikëqyrur tregun e kapitalit. <i>Shënjestra për 2021:</i> kuadër më i mirë ligjor dhe kapacitete të rregullatorëve për mbikëqyrjen e tregut të kapitalit.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kapaciteti i forcuar institucional dhe performancë më e mirë e menaxhimit të financave publike (MFP) në nivel qendror, që kontribuon për balancimin më të mirë të buxhetit dhe uljen e normës së borxhit. ▪ Formulimi më i mirë i politikave monetare dhe zgjerimi i rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit financiar kontribuojnë për një sektor financiar më të qëndrueshëm dhe më të gjerë. <i>Supozimet:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Reformat për stabilitetin makroekonomik dhe fiskal përparojnë në mënyrë të qëndrueshme, por mbeten rreziqet fiskale, kryesisht si rezultat i presionit demografik që vjen nga lindshmëria e ulët dhe emigracioni. Kjo përket në një hapësirë të kufizuar fiskale për manovrim në vitet e ardhshme. ▪ Sektori financiar mbetet përgjithësisht i qëndrueshëm; megjithatë, euroizimi i sektorit bankar dhe i tregut të kapitalit në zhvillim duhet të trajtohen në mënyrë të vazhdueshme. <i>Rreziqet:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Programi i reformës për stabilitetin makro devijon nga objektivat e vendosura për shkak të ciklit zgjedhor dhe përfundimit të marrëveshjes me FMN-në. ▪ Rreziqet e sektorit financiar: euroizimi i lartë i depozitave dhe kredive bankare; përqendrim i lartë i bankave të huaja; dobësitë sistemike të sektorit jo-bankar. 	Deklarata e rezultatit 1 Stabilitet financiar dhe konvergjençë ekonomike e qëndrueshme në sajë të një buxheti më të balancuar dhe të qëndrueshëm me një normë më të ulët të borxhit ndaj PBB-së, institucione të përgjegjshme financiare, dhe treg financiar i zhvilluar dhe i konsoliduar.¹⁶ Treguesit: 1) Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së <i>Studimi bazë 2016:</i> 71% e PBB-së <i>Shënjestra për 2019:</i> 62.8% të PBB-së <i>Burimi:</i> Statistika zyrtare të Ministrisë së Financave 2) Treguesit kyç të MFP-së <i>Studimi bazë 2016:</i> sipas zbatimit të Strategjisë së MFP-së <i>Shënjestra për 2020:</i> siç përcaktohet në Strategjinë e MFP-së në aspektin e progresit <i>Burimi:</i> Raporti i Monitorimit të Strategjisë së MFP-së 3) Raporti i NPL-ve, tregues të sistemit financiar <i>Studimi bazë 2017:</i> norma e inflacionit 2.1% për treguesit e stabilitetit të tregut financiar <i>Shënjestra për 2021:</i> Synimi i inflacionit në masën 3% <i>Burimi:</i> Raportet e Bankës së Shqipërisë; raportet e IFI-së
